

# RAPORTI VJETOR 2017

*Prioritetet e Institucionit për  
vitin 2018*



**AUTORITETI I  
KONKURRENCËS**

## **PËRMBAJTJA**

<b>HYRJA</b> .....	<b>1</b>
<b>ASPEKTE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN 2017</b> .....	<b>1</b>
<b>FJALA E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS</b> .....	<b>3</b>
<b>PJESA E PARË</b> .....	<b>5</b>
<b>DREJTIMET KRYESORE TË POLITIKËS SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2017</b> .....	<b>5</b>
<b>1.1 Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.</b> .....	<b>5</b>
<b>1.2 Legjislacioni sekondar – Rregullore dhe dokumente të miratuara nga Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2017</b> .....	<b>8</b>
<b>PJESA E DYTË</b> .....	<b>9</b>
<b>ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURRENCËS</b> .....	<b>9</b>
<b>2.1 Tregjet e monitoruara</b> .....	<b>9</b>
<b>2.2 Kontrolli i përqendrimeve</b> .....	<b>12</b>
<b>2.3 Tregjet e shërbimit / joprodhuese</b> .....	<b>20</b>
<b>2.4 Tregjet prodhuese</b> .....	<b>34</b>
<b>PJESA E TRETË</b> .....	<b>43</b>
<b>AUTORITETI I KONKURRENCËS PËRBALLË PROCESIVE GJYQËSORE</b> .....	<b>43</b>
<b>3.1 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë (2017)</b> .....	<b>43</b>
<b>3.2 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Apelit (2017)</b> .....	<b>44</b>
<b>3.3 Çështje të mbartura për gjykim nga Gjykata Administrative e Apelit për vitin 2018</b> .....	<b>44</b>
<b>3.4 Çështje të gjykuara nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (2017)</b> .....	<b>46</b>
<b>3.5 Çështje të mbartura për gjykim nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë për vitin 2018</b> .....	<b>46</b>
<b>3.6 Ekzekutimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës</b> .....	<b>48</b>
<b>PJESA E KATËRT</b> .....	<b>50</b>
<b>ROLI I AUTORITETIT TË KONKURRENCËS NË FORMULIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E POLITIKAVE TË TJERA - ADVOKACIA E KONKURRENCËS</b> .....	<b>50</b>

4.1	Vlerësimi i akteve dhe projekt-akteve normative .....	50
4.2	Advokacia e konkurrencës .....	57
<b>PJESA E PESTË</b> .....		<b>59</b>
<b>INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR</b> .....		<b>59</b>
5.1	Kontributi në kuadrin e Integrimit Evropian.....	59
5.2	Bashkëpunimi Ndërkombëtar .....	59
<b>PJESA E GJASHTË</b> .....		<b>63</b>
<b>RISTRUKTURIMI I ORGANIZIMIT TË AUTORITETIT</b> .....		<b>63</b>
6.1	Ristrukturimi i AK .....	63
6.2	Realizimi i buxhetit për vitin 2017 .....	64
6.3	Të ardhurat e realizuara .....	64
6.4	Rekrutimet .....	65
<b>PJESA E SHTATË</b> .....		<b>66</b>
<b>PRIORITETET E AK PËR VITIN 2018</b> .....		<b>66</b>
7.1	Prioritetet e AK për vitin 2018.....	66
7.2	Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE-së .....	66
<b>ANEKS</b> .....		<b>68</b>
<b>VENDIMET E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS</b> .....		<b>68</b>

## Listë Shkurtimesh

<b>AK</b>	Autoriteti i Konkurrencës
<b>AKEP</b>	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
<b>AMA</b>	Autoriteti i Mediave Audiovizive
<b>AMF</b>	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
<b>APP</b>	Agjencia e Prokurimit Publik
<b>BE</b>	Bashkimi European
<b>BERZH</b>	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>BSH</b>	Banka e Shqipërisë
<b>DPT</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
<b>DPP</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit
<b>EBITDA</b>	Të ardhurat përpara zbritjes së interesave, taksave dhe amortizimit
<b>ERE</b>	Enti Rregullator i Energjisë
<b>FSDKSH</b>	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
<b>HHI</b>	Indeksi i përqendrimit Herfindal
<b>ICN</b>	Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës
<b>IPA</b>	Instrumenti i Para-Zgjerimit i BE
<b>KE</b>	Komisioni European
<b>KMK</b>	Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit
<b>Ligji nr. 9121/2003</b>	Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar
<b>MEPJ</b>	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
<b>MFE</b>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>MIE</b>	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
<b>MZHETS</b>	Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>PLATZ</b>	Bursa ndërkombëtare e karburanteve
<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>SHSHB</b>	Shoqata Shqiptare e Bankave
<b>TAIEX</b>	Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi Informacionit i BE
<b>UNCTAD</b>	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin

## HYRJA

### ASPEKTE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN 2017

Ekonomia shqiptare gjatë vitit 2017, shfaqti ritme të përshpejtuara të rritjes ekonomike duke arritur në nivelin 3.8 % të PBB. Sipas Bankës Botërore<sup>1</sup>, progres i rëndësishëm është bërë në fushën e forcimit të besimit të biznesit dhe kërkesës në tregun e brendshëm, nëpërmjet rritjes së investimeve dhe rikuperimit të eksporteve.

Konsumi<sup>2</sup> si faktori që përbën peshën më të madhe në ekonomi, u rrit me rreth 2.92% krahasuar me vitin 2016 ndërsa inflacioni vazhdoi të jetë në nivelet mesatare me trend renës në nivelin prej 2%. Investimet u rritën konsiderueshëm me rreth 9.7% në terma real vjetorë përgjatë nëntë muajve të vitit 2017, duke kontribuar me rreth 1.36 pikë përqindje në rritjen respektive të PBB.

Sektorët ekonomik<sup>3</sup> që sollën kontribut të rëndësishëm në PBB janë: sektori **i ndërtimit**, i cili shënoi një rritje reale vjetore prej rreth 14.88% përgjatë nëntë muajve të vitit 2017, duke dhënë kontributin më të lartë në rritjen e PBB-së prej rreth 1.24 pikë përqindje, në linjë me dinamikën e investimeve totale; **aktivitetet financiare dhe të sigurimit** me një rritje reale vjetore prej rreth 10.81% dhe një kontribut prej 0.3 pikë përqindje në PBB; **industria** me një rritje vjetore prej rreth 2.8% dhe një kontribut prej 0.37 pikë përqindje në PBB; **shitja me shumicë dhe pakicë** me një rritje reale vjetore prej rreth 4.12% dhe një kontribut prej 0.65 pikë përqindje në PBB.

Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” e konsideron shumë të rëndësishëm mirëfunksionimin e tregjeve duke përfshirë në të aktorë dhe faktorë të tij për ti bërë ata më konkurrues, më eficient, më të hapur në dobi të ekonomisë së vendit dhe mirëqënies konsumatore.

Konkurrenca si një forcë kyç i bën tregjet të lira e të dobishme, duke imponuar një garë të “pamëshirshme” ndërmjet të gjithë aktorëve që marrin pjesë në të. Për më tepër, është konkurrenca e lirë ajo që mundëson përdorimin më efektiv të kapitalit, të punës, të kapaciteteve prodhuese dhe të burimeve që disponon shoqëria në një moment të dhënë.

Autoriteti i Konkurrencës gjatë veprimtarisë së tij për vitin 2017, nëpërmjet monitorimeve, vlerësimit të ankesave dhe hetimeve, ka ndërhyrë në mënyrë të vazhdueshme në tregje me problematika të përsëritura si: tregu i karburanteve, tregu financiar dhe i sigurimeve, tregu i telefonisë celulare, tregu i energjisë, tregu i grumbullimit të duhanit, etj.

Gjatë këtij viti janë realizuar:

- 6 (gjashtë) procedura monitorimi përkatësisht në tregun e distribucionit të filmave që shfaqen në kinema, tregun e gazit të lëngshëm të naftës (GLN), tregun e telefonisë

<sup>1</sup> [worldbank.org/en/country/albania/overview](http://worldbank.org/en/country/albania/overview)


<sup>2</sup> [financa.gov.al/files/userfiles/Programimi\\_EkonomikoFiskal](http://financa.gov.al/files/userfiles/Programimi_EkonomikoFiskal)

<sup>3</sup> *Ibid*


celulare, tregun e transportit ndërkombëtar detar, tregun e importit dhe ambalazhimit të kafesë si dhe tregun e importit dhe shitjes së cigareve;

- 11 (njëmbëdhjetë) procedura hetimore përkatësisht në tregun e telefonisë celulare, sektorin bankar, tregun e ngarkim-shkarkimit në portin e Durrësit, tregun e distribucionit të filmave, tregun e tregtimit të lëndës së parë për prodhimin e brumit për bukë, tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së kasave fiskale, tregun i furnizimit me karburant për avionë, tregun e transportit ajror, tregun e transportit ndërkombëtar detar, tregun e grumbullimit të duhanit dhe tregun e importit, depozitimit dhe shitjes së GLN;
- 47 (dyzet e shtatë) vendime të Komisionit të Konkurrencës përkatësisht në tregun e gazit të lëngshëm (GLN), transportit detar dhe ajror, telekomunikacionit, sektorit financiar, ngarkim-shkarkimit në portin e Durrësit, nga të cilat 16 (gjashtëmbëdhjetë) janë autorizime për lejimin e përqëndrimeve në tregun financiar, tregun e telekomunikacionit dhe tregun e shitjes me pakicë.
- mbi 35 (tridhjetë e pesë) vlerësime ligjore në tregun e energjisë elektrike, transportin hekurudhor, tregun e mediave audiovizive etj..

### Vendimet e KK për vitin 2017



### Procedura hetimore në vite



## **FJALA E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS**

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2017 synoi që misioni i tij për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, të ishte në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit dhe në të mirë të të gjithë konsumatorëve. Ne besojmë se konkurrenca e lirë përbën një nga shtyllat e rëndësishme në ekonomi, që rrit eficiencën e tregjeve dhe për rrjedhim, ndikon në rritjen e mirëqenies në terma afatgjatë.

Viti 2017 është konsideruar si viti i konsolidimit të ekuilibrave ekonomikë dhe financiarë të vendit. Ekonomia shqiptare, në vitin 2017, u pozicionua e 75-ta në renditjen e indeksit global të konkurrueshmërisë (GCI), nga pozicioni i 80-të që ishte klasifikuar për vitin 2016, duke lënë pas vendet e rajonit si Serbi, Mal i Zi dhe Bosnje-Hercegovina referuar raportit më të fundit të konkurrueshmërisë, Forumi Ekonomik Global.

Vlerësohet se ekonomia po rikuperon boshllëqet e krijuara në kapacitetet e saj prodhuese, duke dhënë sinjale të qarta për një gjallërim të mëtejshëm në vitin 2018. Përtej optimizimit të arsyeshëm, këto zhvillime mbartin dhe rrezikun potencial të krijimit të situatave të abuzimit me pozitën në treg, fenomene këto që mund të shfaqen në formën e një pozicioni monopolist, të një përqendrimi të madh apo në çdo lloj tjetër me efekt material në zbehjen e konkurrencës në treg.

Nga ky këndvështrim, në veprimtarinë tonë jemi munduar të jemi lojtarë pro aktivë, duke synuar identifikimin dhe parandalimin paraprak të rasteve të mundshme të abuzimit me pozitën në treg, pavarësisht natyrës apo specifikave të tyre. E gjithë kjo është mundësuar nëpërmjet një numri të madh monitorimesh dhe hetimesh përgjatë gjithë vitit të kaluar. Përtej misionit tonë parandalues, një prioritet të veçantë në veprimtarinë tonë ka zënë analiza e pandërprerë e situatës në tregjet me problematika të përsëritura, ku do doja të veçoja tregun e karburanteve, treguan e telefonisë celulare dhe atë të sigurimeve.

E gjithë veprimtaria e Autoritetit është reflektuar në vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës, e cila në total numëron 47 vendime, nga të cilat 16 janë për dhënien e autorizimeve të përqendrimeve. Autoriteti ka qenë vokal në lidhje me nevojën për një sërë ndryshimesh ligjore dhe aktesh normative duke synuar në çdo rast kufizimin e akordimit me ligj të të drejtave ekskluzive apo të kufizimit të konkurrencës.

Siç e përmenda më sipër, gjatë vitit 2018 dhe në periudhën që do të pasojë atë, ekonomia do të përballet me shumë sfida dhe objektiva ambicioze. Nga ky këndvështrim, Autoriteti ka pjesën e tij të kontributeve dhe të përgjegjësisë. Ne jemi të vendosur të zbatojmë me përpikëri të gjithë kuadrin ligjor dhe atë nënligjor në fuqi për të garantuar mbrojtjen e konsumatorit nga gjithë abuzimet që mund të lindin nga deformimi i qëllimshëm apo jo i konkurrencës së lirë. Ndërkohë që ne do të vazhdojmë të jemi partnerë luajalë dhe transparentë, do të jemi shumë rigorozë dhe këmbëngulës në materializimin me objektivitet të gjithë vendimmarrjes dhe gjetjeve tona në veprimtarinë e subjekteve të prekura prej saj. Ne jemi të ndërgjegjshëm se hapat që kemi hedhur janë një pikënisje e mirë, por rruga jonë është e gjatë dhe me shumë sfida përballë një ekonomie në zhvillim.

Ajo që dua të garantoj publikun është se themelet e vendosura janë solide dhe se Autoriteti ka mundur të bëjë progres përgjatë rrjedhës së viteve. Për rrjedhim, ne jemi besimplotë se në të ardhmen hapat tona do të jenë më të sigurt. Autoriteti do të vazhdojë të jetë një institucion i bazuar në integritet, duke respektuar parimet bazë të etikës, transparencës dhe paanshmërisë. Objektiv madhor mbetet instalimi dhe përhapja e një kulture konkurrence gjithëpërfshirëse. Për këtë qëllim, ne do të jemi aktivë në promovimin e të gjithë rasteve dhe agjentëve ekonomikë, të cilët respektojnë ligjin.

Në përfundim, do të dëshiroja të bëja një falënderim të veçantë për të gjithë Komisionerët e Komisionit, përfshirë dhe ata që janë larguar në përfundim të mandatit, për përkushtimin dhe seriozitetin e tyre në përmbushjen e mandatit ligjor të tyre.

Duke ju ftuar të njiheni më në detaje me veprimtarinë e institucionit përgjatë këtij Raporti,

Ju faleminderit,

**Prof.Dr. Juliana Latifi**



## **PJESA E PARË**

### **DREJTIMET KRYESORE TË POLITIKËS SË AUTORITETIT TË KONKURENCËS PËR VITIN 2017**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet rezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2016”, datë 27.04.2017, ka vlerësuar rolin e Autoritetit të Konkurrencës në sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si edhe bashkëpunimin me institucionet e qendrore dhe rregullatore për aktet që mund të prekin funksionimin e konkurrencës në tregje.

#### **1.1 Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.**

Në zbatim të rekomandimeve, AK ka vazhduar veprimtarinë e tij në këto drejtime:

1. Vijimi i procesit të monitorimeve dhe zbatueshmërisë së rekomandimeve në tregjet sensitive në Republikën e Shqipërisë, duke u siguruar që sjelljet e ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg, nuk bien ndesh me ligjin dhe politikën e konkurrencës.

*Në tregun e karburanteve, gazit dhe furnizimit me karburante të avionëve*, ka realizuar procedura hetimore dhëe në përfundim të tyre është shprehur me vendimet si vijon:

- me vendimin nr.476, datë 05.10.2017 “Për zbatimin e vendimit të KK nr. 390, datë 22.12.2015 dhe mbylljen e hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes”;
- me vendimin nr. 470, datë 11.07.2017 “ Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Aeroport”.

Në lidhje me tregun e furnizimit me karburant të avionëve, rezulton se ndërmarrja Air BP Albania Sha, nuk ka marrë asnjë kërkesë formale ose joformale për akses në pajisjet e saj, në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

AK ka monitoruar në terren tregun e gazit të lëngshëm të naftës dhe vlerëson se për periudhën mars-tetor 2017 nuk vërehen shenja të kufizimit apo shtrembërimit të konkurrencës.

Të dyja tregjet janë në procesin e monitorimit.

*Tregu i sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta*. KK, është shprehur me 2(dy) vendime në lidhje me këtë treg si vijon:

- vendimin nr. 443 datë 30.11.2016 “Për masat dhe detyrime për ndërmarrjet e sigurimit dhe disa rekomandime për AMF, mbi rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”;
- vendimin nr. 448, datë 23.01.2017 “Për masat dhe detyrime për ndërmarrjet e sigurimit dhe disa rekomandime për AMF, mbi rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik, për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” ku, u la në fuqi vendimi nr. 443, datë 30.11.2016 i KK.

Tregu i sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta është në proces monitorimi nga AK, ku rezulton se:

- ndërmarrjet Intersig V.I.G. Sha; Sigal Uniqa Group Austria Sha; Atlantik-Insurance Company Sha; Sigma Interlbanian V.I.G Sha, që operojnë në tregun e sigurimeve, kanë zbatuar angazhimet sipas vendimit të KK ;
- ndërmarrjet kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me më shumë se një broker;
- AMF ka përfunduar draftimin e bazës ligjore për implementimin e sistemit Bonus/Malus;
- AK ka përfunduar vlerësimin ex-ante të bazës ligjore për implementimin e sistemit Bonus/Malus.

**Në tregun farmaceutik**, KK është shprehur me vendimin nr. 418, datë 30.05.2016 “Për disa rekomandime mbi vendimin e Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)”, lidhur me problematikat e evidentuara në aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli;

AK ka qenë në bashkëpunim të vazhdueshëm me FSDKSH gjatë vitit 2017 nga ku rezulton se, Këshilli i Administrimit nuk ka miratuar akte nënligjore të reja në zbatim të rekomandimeve.

**Në lidhje me tregun e prokurimeve publike**, KK është shprehur me vendimin nr. 441, datë 22.11.2016 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e prokurimit publik të shërbimit të konsulencës”.

AK vazhdon të ketë në monitorim zbatueshmërinë e këtij vendimi, ndërkohë që nuk ka asnjë informacion nga Agjencia e Prokurimit Publik mbi nisma për ndryshime ligjore.

2. **Lidhur me sektorin bankar**, AK ka kryer një hetim të përgjithshëm dhe në përfundim të tij KK është shprehur me vendimin nr. 453, datë 07.03.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe bankat e nivelit të dytë”.

AK ka monitoruar zbatimin e vendimit të KK, rekomandime të cilat janë marrë në mënyrë të konsiderueshme, nga Banka e Shqipërisë, Shoqata e Bankave, si dhe Bankat e nivelit të dytë, dhe tregu vazhdon të jetë nën monitorim.

3. AK ka realizuar **advokacinë e konkurrencës** nëpërmjet promovimit dhe njohjes të programit të lehtësimit nga gjobat, duke synuar ndërgjegjësimin e bizneseve për përfitimet që vijnë nga ky program. Në drejtim të rritjes dhe ndërgjegjësimin publik për një mjedis konkurrues dhe përfitimet që vijnë nga konkurrenca, u organizuan tryeza të rrumbullakta me komunitetet e biznesit, në qytetet e Fierit, Elbasanit dhe Durrësit, gjatë muajve tetor - nëntor 2017.
4. AK, ka vazhduar **bashkëpunimin me institucionet publike**, në zbatim të nenit 69 të ligjit nr. 9121/2003, prej të cilave është kërkuar paraprakisht vlerësimi ligjor për projektakte normativë, që kanë si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë, veçanërisht ky bashkëpunim është realizuar me entet rregullatore, si ERE, AMA, AMF, AKEP. Ky bashkëpunim nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar me institucionet e tjera, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të AK kundrejt tyre.
5. AK është në **proces të rishikimit të ligjit nr. 9121/2003**. Aktualisht, është duke u realizuar një analizë e kuadrit ligjor, mbi bazë të krahasimit me legjisllacionin e disa vendeve të BE, si dhe evidentimi i problematikave që ka nxjerrë zbatimi i ligjit në praktikë. Me miratimin e nje projekti bashkëpunimi midis AK dhe BERZH “Asistencë teknike për Autoritetin e Konkurrencës - Rritje kapacitetesh, mbështetja për legjisllacionin dhe advokacinë”, synohet mbështetja me një ekspertizë të specializuar, për të bërë të mundur rishikimin e ligjit, në drejtim të propozimeve konkrete, për shtesa dhe ndryshime në të.
6. Në lidhje me **kuadrin ligjor sekondar**, AK, gjatë vitit 2017, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin edhe nga procesi i integritimit, miratoi rregulloren “Për kategoritë e marrëveshjeve të transferimit të teknologjisë”, me vendimin nr. 489, datë 20.12.2017 të KK, si dhe vuri në dispozicion për komunitetin e biznesit, broshurën informuese “Programi i përputhshmërisë me rregullat e konkurrencës”.
7. Gjatë vitit 2017, është bërë i mundur **forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative**. Nëpërmjet ristrukturimit organizativ të AK, me vendimin nr.43/2017 të Kuvendit të RSH “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës” është realizuar një ristrukturim i AK, me synimin për t’ju përshtatur më mirë diversitetit të tregjeve, nevojave të vetë zhvillimit ekonomik të vendit, në funksion të proceseve integruese, që po ecën Shqipëria, duke e përshtatur strukturën aktuale me atë të vendeve të BE.

Nga ana tjetër, është realizuar edhe një veprimtari aktive e AK në drejtim të mbrojtjes së vendimeve të Komisionit të Konkurrencës në proceset gjyqësore, çka rezulton që gjatë vitit 2017, çdo çështje që ka të bëjë me vendimmarrjen e KK është lënë në fuqi nga gjykatat.

## **1.2 Legjislacioni sekondar – Rregullore dhe dokumente të miratuara nga Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2017**

Në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit dhe Planit Kombëtar të Integritimit Evropian, gjatë 2017, AK miratoi nismat ligjore, si më poshtë:

### **1. Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve të transferimit të teknologjisë”, miratuar me vendimin nr. 489, datë 20.12.2017 të KK.**

Kjo rregullore është përshtatur dhe përafruar plotësisht me Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 316/2014, datë 21 mars 2014 "Për zbatimin e nenit 101(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian për Kategoritë e Marrëveshjeve të Transferimit të Teknologjisë"<sup>4</sup>.

Rregullorja e re plotëson kuadrin ligjor në fushën e konkurrencës, duke parashikuar mënyrën se si kryhet procesi i vlerësimit për kategoritë e marrëveshjeve të transferimit teknologjik. Nëpërmjet kësaj rregulloreje, rregullohet shprehimisht që marrëveshjet e transferimit të teknologjisë, të lidhura ndërmjet dy ndërmarrjeve që lejojnë prodhimin e produkteve të kontraktuara, u njihet e drejta e përjashtimit nga kategoria e marrëveshjeve të ndaluara, me kusht që pjesa e kombinuar e palëve në treg të mos tejkalojë 20% të tregut përkatës të prekur. Në lidhje, me ndërmarrjet, palë të një marrëveshjeje, të cilat nuk janë ndërmarrje në të njëjtin treg përkatës, përjashtimi do të zbatohet me kusht që pjesa e tregut e secilës palë të mos tejkalojë 30% të tregut përkatës të prekur.

### **2. Broshurë informuese “Programi i përputhshmërisë me rregullat e konkurrencës”**

Ky dokument, bazohet në të njëjtin dokument që Komisioni Evropian<sup>5</sup> ka përgatitur për komunitetin e biznesit si dhe është mbështetur në praktikat më të mira dhe të njëjtat programe, që kanë hartuar autoritete homologe apo vende anëtare të tjera të BE.

Nëpërmjet këtij dokumenti, AK synon të inkurajojë ndërmarrjet që të investojnë burimet e nevojshme njerëzore, të cilat do t'i ndihmojnë ato (ndërmarrjet) të kuptojnë sesi përputhshmëria me rregullat e konkurrencës, mund të jetë një investim fitimprurës për to dhe, si të parandalohet shkelja e rregullave të konkurrencës, duke vepruar sipas standardeve ligjore dhe etike në fushën e konkurrencës.

Ky dokument, në kuadër të “Advokacisë së konkurrencës”, u bë objekt diskutimi edhe në tryezat e të rrumbullakta të organizuara me komunitetet e biznesit, në qytetet e Fierit, Elbasanit dhe Durrësit, gjatë muajve tetor - nëntor 2017.

---

<sup>4</sup> Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike”, miratuar me VKK nr.179 datë 2.3.2011, shfuqizohet.

<sup>5</sup> <https://publications.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/78f46c48-e03e-4c36-bbbe-aa08c2514d7a/language-en>.

## PJESA E DYTË


### ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURENCËS

#### 2.1 Tregjet e monitoruara

AK, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003 ka realizuar monitorime dhe analiza të tregjeve për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Nëpërmjet monitorimeve vlerësohen elementet konkurruese siç janë: strukturat e tregut dhe dinamikat e zhvillimit të tij, sjellja e ndërmarrjeve në treg në lidhje me konkurrentët e tjerë, konsumatorët, si dhe barrierat ligjore dhe ekonomike për hyrësit e rinj në treg.

#### Tregjet e monitoruara gjatë vitit 2017



Gjatë vitit 2017 u realizuan monitorimet si më poshtë vijon:

#### *Tregu i shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës*

Sekretariati i AK realizoi një monitorim në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës. Nga monitorimi u konstatua se tregu nuk paraqet barriera ligjore, por ka barriera të larta ekonomike, që kanë të bëjnë me investimin fillestar për infrastrukturën e sallave dhe teknologjinë e transmetimit.

Tregu i shfaqjes së filmave në kinema rezulton një treg i përqendruar me karakteristikat e një tregu oligopolistik, ku operojnë tre ndërmarrje të cilat njëkohësisht shpërndajnë dhe shfaqin filmat në kinema. Nga monitorimi i realizuar, u konstatua se ndërmarrjet që operojnë në treg përkatësisht: “Empire” Shpk (Empire), “Millenium” Shpk (Millenium) dhe “Cineplexx” Shpk (Cineplexx) kishin sjellje të njëjtë në lidhje me çmimin e shitjes së biletave, ditët e eventeve dhe në mënyrën e organizimit të ofertave. Për këto arsye, u gjykua se në tregun e shfaqjes së filmave në kinema, mund të kishte shenja të një sjelljeje të bashkërenduar të ndërmarrjeve, në pjesën e shpërndarjes dhe të sigurimit të të drejtave të transmetimit, kryesisht për filmat e huaj, sjellje e cila mund të përbënte shkelje të nenit 4, të ligjit nr. 9121/2003.

Për këto arsye, KK me vendimin nr. 466, datë 20.06.2017 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shpërndarjes dhe shfaqjes së filmave në rrjetet e kinemave në Tiranë”, vendosi fillimin e procedurës së hetimit paraprak.

*Tregu i importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes*

Në datën 1 janar 2017, hynë në fuqi ndryshimet në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku parashikohet vendosja e akcizës për kategorinë e gazit të lëngshëm natyror (GLN), vetëm për automjetet, në vlerën 8 lekë/litër pa T.V.Sh. Nisur nga sa më sipër, u realizua monitorimi i tregut të shitjes së produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes, ku u konstatua se ndërmarrjet “Kast & Gas”, “Gas Group”, “Koka Gas”, tregtonin me të njëjtin çmim. Kjo sjellje, mund të përbente një kufizim të konkurrencës në kuptim të neneve 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003.

Për sa më sipër, KK me vendimin nr. 446, datë 16.01.2017 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes”.

*Tregu me pakicë i shërbimeve celulare*

Monitorimi në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, filloi me depozitimin e disa ankesave (qendra “Konsumatori Shqiptar”, si dhe 3 ankimues individë), për planet tarifore që ofronin ndërmarrjet “Vodafone Albania”, “Telekom Albania”, “Albtelecom”. Nga monitorimi, u konstatua se tre ndërmarrjet kishin ndryshuar paketat standarde në periudhën 27 mars 2017 - 4 prill 2017 për klientët me parapagesë, e cila mund të përbente një praktikë të bashkërenduar sipas nenit 4, të ligjit nr. 9121/2003.

Për këto arsye, KK, me vendimin nr. 461, datë 23.05.2017 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”.

*Tregu i transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në Portin e Vlorës*

Pranë AK, shoqëria "A.Bus" Shpk, e cila kryen aktivitet në fushën e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus, depozitoi Formularin Tip të Ankesës, kundrejt agjencisë "G Travel" Shpk, përfaqësuese e shoqërisë së tragetit "N.T.M Lda", që operon në linjën Vlorë - Brindisi dhe anasjelltas, për diferencim në çmimin e biletave të udhëtarëve.

Nga monitorimi i realizuar, rezultoi se shoqërisë ankimuese “A.Bus” Shpk i ishte refuzuar shërbimi për të udhëtuar me tragetin e kompanisë “N.T.M Lda”, duke vendosur kushte të padrejta tregtare lidhur me:

- Rritjen e çmimit të biletës për pasagjerë dhe automjete (autobusë);
- Detyrimin e saj për të udhëtuar vajtje – ardhje vetëm me tragetin e kësaj kompanie;
- Nënshkrimin e një kontrate me kushte dhe detyrime të padrejta tregtimi (draft kontrata kundrejt një garancie financiare).

Për sa më sipër, KK, me vendimin nr. 455, datë 28.03.2017 "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në Portin e Vlorës" vendosi fillimin e procedurave hetimore.

#### *Tregu i importit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë*

Gjatë vitit 2017 u realizua monitorimi i tregut të importit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë dhe analizimi i kushteve të tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Nga monitorimi rezultoi se:

- Tregu i importit të kafesë është një treg me një numër të madh konkurrentësh, të cilët zotërojnë pjesë relativisht të vogla, për këtë arsye vlerësojmë se tregu i importit të kafesë së të gjitha llojeve është një treg jo i përqendruar;
- Nga analiza e të dhënave rezultoi se kafeja e pjekur, që importohet në Shqipëri, zë rreth 26% të sasisë totale të importuar. Ndërsa kafeja kokërr e papjekur, zë pjesën më të madhe të tregut me rreth 74%, e cila përpunohet dhe ambalazhohet në vend;
- Referuar pjesëve të tregut të ndërmarrjeve sipas sasisë së importuar rezultoi se asnjëra nga ndërmarrjet që ushtron veprimtari në tregun e importit të kafesë nuk zotëron pozitë dominuese në treg, në kuptim të nenit 8, të ligjit nr. 9121/2003;
- Nga monitorimi rezultoi se çmimet e shitjes, të aplikuara nga ndërmarrjet, janë të ndryshme dhe me diferenca domethënëse, sjellje e cila nuk përbën shenja të kufizimit të konkurrencës, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

Në përfundim, u konkludua se në tregun e importit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë nuk ka shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës sipas neneve 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003.

#### *Tregu i importit dhe shitjes së cigareve*

Nga monitorimi në tregun e importit dhe shitjes së cigareve të paketuara, për të evidentuar nëse ka pasur ndonjë rritje të pajustificuar të çmimeve të tregtimit me pakicë për cigaret e paketuara, u arrit në përfundimin se:

- Në tregun e cigareve në Shqipëri, ka disa lloje markash të cigareve të paketuara (paketa), të cilat tregtohen nga importues dhe distributorë të ndryshëm.
- Cigaret janë mall akcize, që paguhet në bazë të shkallës tatimore në fuqi, në çastin kur tatimi bëhet i detyrueshëm për t'u paguar.
- Tregu i importit të duhanit ka strukturë oligopolistike, duke qenë se në treg operojnë 7 ndërmarrje. Bazuar në pjesët e tregut të importeve të këtyre ndërmarrjeve, fuqisë kundërvepruese të blerësve, vlerësojmë se asnjë nga ndërmarrjet që ushtrojnë



veprimtari në tregun përkatës, nuk përmbushin kriteret e nenit 8, të ligjit nr. 9121/2003 dhe nuk kanë pozitë dominuese në tregun përkatës.

- Nga monitorimi i tregut pranë pikave të shitjes, nuk u vërejtën shenja të rritjes së çmimit të shitjes me pakicë për cigaret e paketuara.


Për sa më sipër, për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe shitjes me pakicë të cigareve të paketuara, si dhe për të vlerësuar efektet e ndryshimeve të akcizës së cigareve, gjatë vitit 2018 ky treg do të mbahet në monitorim.

## 2.2 Kontrolli i përqendrimeve

Gjatë vitit 2017 AK, në bazë të neneve 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121/2003 realizoi vlerësimin e 22 rasteve të transaksioneve të njoftuara pranë tij, nga të cilat 16 prej tyre kanë kaluar në procedurë vlerësimi dhe janë autorizuar nga KK dhe 6 prej tyre nuk kanë plotësuar kriteret e ligjit nr. 9121/2003.

Të gjitha rastet e autorizuara, kanë kaluar në procedura paraprake të vlerësimit sipas parashikimit të nenit 56, të ligjit nr. 9121/2003 dhe koha mesatare e realizimit të procedurës, për vitin 2017, ka qenë 24 ditë, ndjeshëm më e ulët nga afati 2-mujor, i parashikuar në ligjin nr. 9121/2003, për autorizimin e një përqendrimi. Procedurat janë realizuar në zbatim të udhëzimit “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”, plotësisht i përafuar me “Njoftimi i Komisionit mbi procedurat e thjeshtuara në trajtimin e disa përqendrimeve” sipas rregullores së këshillit (EC) Nr 139/2004.<sup>6</sup>

Sektorët e ekonomisë me numrin më të madh të transaksioneve të ndryshimit të kontrollit për vitin 2017 janë si më poshtë:



- sektori i tregtisë më pakicë me 8 raste të autorizuara;
- sektori i telekomunikacionit me 4 raste të ndryshimit të kontrollit ;
- sektori financiar me 3 raste;
- Mjetet motorrike me 1 rast.


Nga vlerësimi i përqendrimeve, rezulton se:

- 46% e rasteve të njoftuara janë transaksione, të cilat kanë ndodhur në tregun e jashtëm, 10 vendime autorizimi;

<sup>6</sup> <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/ALL/?uri=CELEX%3A32004R0139>



- 27% e rasteve të njoftuara janë transaksione, që kanë ndodhur në tregun shqiptar, 6 vendime autorizimi;
- 27% janë njoftime, të cilat nuk kanë përmbushur kriteret për t'u autorizuar nga KK.



### 2.2.1. Transaksione në tregun e brendshëm

#### *Tregu i telefonisë celulare*

Nga rastet e njoftuara në tregun shqiptar, AK ka vlerësuar si të rëndësishme autorizimet e përqendrimeve të realizuara në tregun e telefonisë celulare.

Në muajin korrik 2017, AK u vu në dijeni nëpërmjet një shkrese të dërguar nga Plus Communication Sha, mbi fillimin e procedurës së transferimit të spektrit të frekuencës në masën 50%, drejt operatorit Vodafone Albania Sha dhe 50%, drejt operatorit Telekom Albania Sha si dhe komunikimet zyrtare të këtij operatori me AKEP.

AK kërkoi bashkëpunimin më AKEP për vlerësimin e transaksionit të synuar, duke qenë se tregu i telefonisë celulare është një treg i rregulluar dhe i mbikëqyrtur.

Në muajin tetor 2017, palët blerëse, në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 9121/2003, filluan procedurat e njoftimit të transaksionit për vlerësimin e të cilit depozituan pranë AK Marrëveshjen për Transferimin e Spektrit dhe Marrëveshjen për Zgjidhjen me Pajtim.<sup>7</sup>

Në zbatim të nenin 74, të ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, “Plus Communication” Sha, paraqiti kërkesë në AKEP për miratim paraprak të transferimit të spektrit të frekuencave. AKEP në vendimin nr. 20, datë 13.11.2017 “Për

<sup>7</sup> Për shkak të mosmarrëveshjeve në lidhje me njohjen e detyrimeve që 3 operatorët e tjerë i kishin “Plus Communication” në lidhje me tarifën asimetrike, palët nënshkruan të kësaj marrëveshjeje por edhe palët treta, të përfshira në konflikte gjyqësore të papërfunduara, njihen me vlerën e detyrimit ndaj Plus dhe bien dakord mbi mënyrën e pagesës, sipas kushteve të parashikuara në marrëveshje respektive me Vodafone, Albtelecom dhe Plus Communication.

dhënien paraprakisht të miratimit për transferimin e të drejtës së përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit “Plus Communication” Sha, tek sipërmarrësit Telekom Albania Sha dhe Vodafone Albania Sha”, konkludoi se:

- Spektri që zotërojnë aktualisht të tre operatorët, mënyra e shfrytëzimit, shërbimet e ofruara, teknologjitë e aplikuara, numri i pajtimtarëve etj., mundëson që transferimi i spektrit nga “Plus Communication” Sha të mos ndikojë në konkurrencën në treg;
- Ky spektër shtesë mendojmë se do të shfrytëzohet nga dy operatorët për rritjen e kapaciteteve të transmetimit, për shkak të kërkesës për trafik më të madh të dhënash (numër më të madh pajtimtarësh);
- Sipërmarrësi/t, të cilëve u kërkohet që t’i kalojë e drejta e përdorimit të radiofrekuencës, Vodafone Albania Sha dhe Telekom Albania Sha i përmbushin të gjitha kërkesat e ligjit nr. 9918/2008 dhe rregullat përkatës, të zbatueshme nga AKEP, sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Për sa më sipër AKEP vendosi :

- Të japë paraprakisht miratimin, për transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication Sha tek sipërmarrësit Vodafone Albania Sha dhe Telekom Albania Sha.
- Palët në proces, për periudhën deri në përfundimin e afatit të tranzicionit, të përcaktuar në autorizimet individuale përkatëse pas marrjes së miratimit nga AK, të veprojnë në përputhje me përcaktimet ligjore dhe kuadrin rregullator të fushës, përfshi edhe detyrimet financiare dhe individuale të Autorizimeve Individuale përkatëse.
- Sipërmarrësi Plus Communication Sha, ka detyrimin e informimit të përdoruesve të shërbimit publik të komunikimeve elektronike të ofruara nga ky sipërmarrës, që pasi të përfundojë afati i transferimit të së drejtës së përdorimit të frekuencave sipas autorizimeve individuale, nuk do të kenë më mundësi për mbajtjen dhe përdorimin e numrave që disponojnë sipas kartave SIM, të emetuara dhe të dhëna nga sipërmarrësi Plus Communication Sha.

Referuar objektit të Marrëveshjes, treg përkatës u konsiderua tregu i frekuencave dhënë në përdorim të operatorit Plus Communication Sha nga AKEP (frekuencat GSM 900MHz, 1800MHz dhe 2100MHz). Transaksioni i paraqitur, shfaqte tregje të prekura dhe të lidhura me tregun përkatës, përkatësisht tregun me pakicë të telefonisë celulare.

Nga vlerësimi i strukturës së tregut të frekuencave, u konstatua se pas transferimit, operatori Vodafone Albania Sha do të forconte pozitën dominuese, duke rritur pjesën e tregut ndërmjet vlerave 38%-42% në varësi të llojit të frekuencës, kurse operatori Telekom Albania Sha, do të rriste pjesën e tregut por pa kaluar nivelin e ndërmarrjes me pozitë dominuese.

Duke qenë së tregu i telefonisë celulare është një treg i vlerësuar vazhdimisht nga AK si dhe duke ju referuar statistikave, u vu re se ndërmarrja Plus Communication Sha paraqiste

tregues të ulët të performancës financiare dhe teknike. Nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori Plus Communication Sha në AK u pohua se “Gjatë gjithë viteve të operimit në treg, që nga viti 2010, shoqëria ka rezultuar me humbje të konsiderueshme. Humbjet e akumuluar në vite kapin shifra të konsiderueshme dhe për këtë arsye aksionarët e shoqërisë, kanë ndërmarrë dy herë masa ristrukturimi të kapitalit për të mbuluar humbjet.”

Neni 13, pika 3 e ligjit nr. 9121/2003, parashikon se një përqendrim mund të mos ndalohet, në rastet kur ndërmarrja palë në përqendrim, rrezikon seriozisht të falimentojë dhe nuk ka mundësi për riorganizimin e veprimtarisë së saj ose ndërmarrja duhet të dalë nga tregu në një të ardhme të afërt, pavarësisht forcimit të pjesës së tregut të ndërmarrjeve palë në marrëveshje. Në vijim të analizës, AK vlerësoi ndikimin e transaksionit në tregun e shitjes me pakicë dhe në konsumatorin fundor, nga ku rezultoi se tregu i shitjes me pakicë (tregu i telefonisë celulare) është një treg i përqendruar me barriera në hyrje për shkak të numrit të kufizuar të licencave. Ky treg, kërkon investime shumë të larta fillestare të cilat mund të sjellin barriera në hyrje/dalje nga tregu dhe karakterizohet nga struktura oligopoli e tregut.

Për shkak të portabilitetit të numrit si dhe pjesës së ulët të tregut që zotëron ndërmarrja Plus Communication Sha, dalja nga tregu e këtij operatori nuk do të sjellë ndryshime të ndjeshme të strukturave të tregut.

Referuar rasteve të ngjashme të trajtuara nga autoritetet homologe në BE, industria e telefonisë celulare që nga viti 2010 është prekur nga reduktimi i numrit të operatorëve në treg, që kanë qenë objekt vlerësimi dhe monitorimi të vazhdueshëm prej tyre.

Për sa më sipër, KK në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 u shpreh me:

- vendimin nr. 484, datë 23.11.2017 “Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes Plus Communication Sha tek Vodafone Albania Sha; dhe
- vendimin nr. 485, datë 23.11.2017 “Për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes Plus Communication Sha tek Telekom Albania Sha”,
- Vendosi:
- Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes Plus Communication Sha, tek Vodafone Albania Sha dhe PLUS Communication Sha tek Telekom Albania Sha
- Detyrimin e AKEP, për të siguruar frekuenca të lira për çdo hyrës të ri në treg.
- Pas përfundimit të transferimit të spektrit, AKEP-i të kryejë analizën e tregut të telefonisë celulare, duke përcaktuar operatorët me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT), sipas kërkesave të Kreut VI, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet

elektronike në RSH”, i ndryshuar. AKEP-i, për nxitjen e konkurrencës në treg, të vendosë kushte dhe detyrime të veçanta sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 9918/2008 ndaj OFNT-ve dhe në rast moszbatimi, ta parashtrijë rastin përpara Autoritetit të Konkurrencës.

- Autoriteti i Konkurrencës, të realizojë vlerësimin e tregut pas përqendrimit, mbështetur në analizën e AKEP.

#### *Tregu i sigurimit të jetës*

Pranë AK, në muajin prill 2017 u njoftua kontrata për shitjen e 90% të aksioneve të shoqërisë Insig Jeta Sha, tek dy persona fizikë, z. S. M. dhe z.Sh. K.

Në zbatim të nenit 6, pika 2 të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtaritë e shoqërisë së sigurimit/risigurimit”, ndërmarrja Eurosig Sha, zotëruese e 100% të kuotave të ndërmarrjes Insig Sha, me vendimin e aksionarëve miratoi në parim ndarjen e shoqërisë Insig Sha, në dy shoqëri pritëse të themeluara rishtazi, Insig Sha dhe Insig Jete Sha.

Pas shitjes, shoqëria Target, Insig Jeta Sha, do të zotërohet në masën 10% nga shoqëria Eurosig Sha; 45 % nga S. M. dhe 45% nga SH. K.

Në zbatim të nenit 13, të ligjit nr. 9121/2003, vlerësimi i përqendrimeve u mbështetet në analizën e efciensave ekonomike dhe përfitimet e konsumatorit, e cila e shprehur në terma realë ka të bëjë me uljen e çmimit dhe rritjen e cilësisë së shërbimit.

Nga vlerësimi i strukturave të tregut, u konstatua se tregu i sigurimit të jetës është një treg i vogël, i cili zë rreth 6.3% të tregut të sigurimeve, ku produkti kryesor është “Jeta e debitorit”, produkt i detyrueshëm për individët me detyrime kredimarrjeje në banka.

Tregu i sigurimit të jetës, paraqet një strukturë oligopolistike me tregues të lartë të përqendrimit të tij (HHI=4536) për shkak të numrit të kufizuar të ndërmarrjeve në treg.

Bazuar në analizën e indikatorve makroekonomikë GIS (Global Insurance Statistics), të cilët masin performancën dhe konkurrueshmërinë e tregut të sigurimeve në tregun e brendshëm si dhe krahasimin e indikatorëve me tregun e jashtëm, u konstatua se indeksi i penetrimit dhe indeksi i densitetit në tregun shqiptar, janë në nivele shumë të ulta krahasuar me vendet e OECD, gjë e cila tregon se tregu i sigurimit të jetës është i ngurtë, me mungesë interesi dhe kërkesë nga konsumatorët. Duke qenë se një pjesë e produkteve janë sigurime vullnetare, është shumë i rëndësishëm përdorimi i mekanizmave të marketingut, për nxitjen e interesit dhe rritjen e kulturës për përfitimet e skemës.

Pas transaksionit, nuk pritet të ketë ndryshime në strukturën e tregut të sigurimit të jetës, ku ushtron veprimtarinë shoqëria Insig Jete Sha, pasi ky transaksion nuk do të shkaktojë mbivendosje horizontale të veprimtarive të palëve, si dhe të tregjeve të prekura.

Gjithsesi, si para dhe pas transaksionit asnjëra nga palët në marrëveshje, nuk zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës të sigurimeve të jetës.

Nga administrimi i dokumentacionit financiar të paraqitur nga palët blerëse, u vlerësua se dy personat fizikë, kanë garanci financiare për të siguruar performancë më të mirë të shoqërisë Insig Jete Sha.

Për sa më sipër, KK konstaton se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe nëpërmjet vendimit nr. 478, datë 26.10.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 90% të ndërmarrjes Insig Jete Sha, nga Eurosig Sha tek z. SH. K. dhe z. S. M.” vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar.

### *Tregu bankar*

Në korrik 2017, AK mori njoftim në lidhje me transaksionin financiar, që realizonte shitjen dhe transferimin e disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të shoqërive Veneto Banca S.p.A tek Intesa Sanpaolo S.p.A. në Itali.

Ky transaksion, përpara shqyrtimit dhe autorizimit nga AK ishte autorizuar nga AGCM (Autoriteti i Konkurrencës në Itali). Për ruajtjen e stabilitetit financiar, Qeveria Italiane, Ministria Italiane e Financave, Banka e Italisë si dhe Banka Qendrore Evropiane dhe Komisioni i BE, parashikuan një sërë masash, me qëllim shmangien e pasojave serioze sociale, që do të kishin rrjedhur nga procedurat e likuidimit të detyrueshëm administrativ për Banca Popolare di Venecia S.p.A dhe Veneto Banca në Itali.

Ky transaksion, u shqyrtua nga AK për shkak të xhiros që realizonin degët e këtyre bankave në tregun shqiptar. Nga vlerësimi i strukturës së tregut bankar si dhe pjesëve të tregut që zënë Veneto Banka Sha dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania Sha, tregu bankar paraqitet me një strukturë të pandryshuar në vitet e fundit. Ky treg, përbëhet nga 16 banka me kapital privat. Pjesa më e madhe e tyre kontrollohet nga filialet e grupeve të huaja bankare me origjinë të kapitalit nga BE dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre, bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në kuadrin rregullator në fuqi.

Tregu bankar shqiptar vlerësohet si treg mesatarisht i përqendruar në terma të aktiveve, shërbimit të depozitave dhe të kredive.

Pas përqendrimit, pjesa e kombinuar e tregut që do të zotërojnë filialet e bankave, palë në transaksion, Veneto Banka Sha dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania Sha, pritet të mos ketë ndryshime domethënëse, duke mbetur në nivelin rreth 13% dhe për pasojë, transaksioni nuk do të sjellë ndryshime në tregun bankar.

Ky përqendrim, nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, pasi pas transaksionit në treg nuk krijonte ose forconte pozitë dominuese të palës blerëse. Për këto arsye KK, me vendimin nr. 474, datë 14.09.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të ndërmarrjes Veneto Banca S.p.A nga Intesa Sanpaolo S.p.A”, autorizoi këtë përqendrim.

### *Tregu i shitjes me pakicë*

Në këtë treg gjatë vitit 2017 janë realizuar 8 procedura përqendrimi, nga të cilat në dy raste transaksioni ka ndodhur mes ndërmarrjeve në tregun shqiptar.

Pranë AK u njoftua transaksioni i realizuar mes një shoqërie shqiptare Marketing & Distribution Shpk dhe një shoqërie ndërkombëtare, JT International Holding B.V. Shoqëria që shitet JT International Tirana Shpk është degë e JT International Holding B.V. dhe palët në marrëveshje, duke qënë se plotësonin kriteret ligjit nr. 9121/2003, iu nënshtruan procedurës së kontrollit të përqendrimit.

Nga vlerësimi i strukturës së tregut të importit të cigareve u konstatua se pala blerëse, zotëron 12% të tregut dhe pala shitëse, nuk ka realizuar importe për periudhën para përqendrimit (2015-2016). Transaksioni i vlerësuar nuk do të ndikojë në strukturën e tregut të cigareve, e cila do të jetë e pandryshuar pas përqendrimit.

Për këtë arsye, KK me vendimin nr. 452, datë 07.03.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të JT International Tirana Shpk nga Marketing & Distribution Shpk nëpërmjet JT International Holding B.V”, autorizoi përqendrimin.

### *Tregu i shitjes së pajisjeve kompjuterike, software dhe hardware*

Pranë AK u njoftua shitja dhe transferimi i 49% të kapitalit të shoqërisë ITD Shpk nga shitësi Investment Joti – Infosoft Group Shpk tek blerësi Balfin Shpk.

Nga vlerësimi i tregut përkatës, i cili u përcaktua si tregu i importit dhe tregimit të pajisjeve kompjuterike, software dhe hardware, rezulton se në treg veprojnë 671 shoqëri dhe treguesi i përqendrimit të tregut Hirschman-Herfindahl (HHI) është në nivelin 746 që tregon për një strukturë konkurrenciale të tregut.

Palët në transaksion, operojnë në tregje të ndryshme, përkatësisht shoqëria që shitet në tregun e rrjedhjes së sipërme (importit dhe shitjes me shumicë) dhe blerësi, në tregun e rrjedhjes së poshtme (shitjes me pakicë), për pasojë ky përqendrim nuk sjell asnjë ndryshim në tregun përkatës.

Për këto arsye, KK, me vendimin nr. 465, datë 20.06.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 49% të ndërmarrjes ITD Shpk, nga Investment Joti-Infosoft Group Shpk tek Balfin Shpk”, autorizoi përqendrimin.

#### **2.2.2. Transaksione në tregun e jashtëm**


Në zbatim të nënit 12 të ligjit nr.9121/2003, objekt i vlerësimit të përqendrimit janë rastet, të cilat ndodhin në tregun e jashtëm por që realizojnë të ardhura në tregun shqiptar, në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë. Komisioni i Konkurrencës, për vitin 2017, ka autorizuar disa raste të tilla, me anë të vendimeve të radhitura mëposhtë:

1. Vendimi nr. 456, datë 28.03.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Tobacco Press d.o.o. Mostar dhe Aseteve të Duhanit të Fabrika Duhana Sarajevo d.d. nga British American Tobacco Investments Limited”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i importit dhe tregtimit të duhanit të prodhuar nëpërmjet makinerive (FMC).
2. Vendimi nr. 457, datë 11.04.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Reynolds American Inc. nga shoqëria Batus Holding Inc”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i importit dhe tregtimit të duhanit të prodhuar nëpërmjet makinerive (FMC).
3. Vendimi nr. 459, datë 25.04.2017 “Për autorizimin e përqendrimit e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Fannie May Confections Brands Inc. nga shoqëria Ferrero International S.A”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave prej çokollate; tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave në formë kremi; tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave me përmbajtje qumështi dhe snacks të ëmbël; dhe tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave prej sheqeri.
4. Vendimi nr. 463, datë 06.06.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrjeje të re, të pavarur me funksione të plota ndërmjet shoqërive BMW AG / Daimler AG / Ford Motor Company / Dr.Ing. h.c.F. Porsche Aktiengesellschaft”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu për instalimin, operimin dhe mirëmbajtjen e një infrastrukture karikimi publike të aksesueshme për automjetet elektrike me bateri (BEV).
5. Vendimi nr. 464, datë 06.06.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të rrjetit të shpërndarjes së shoqërisë Fabrika Duhana AD Banja Luka si dhe përfitimi i 100% i aksioneve të Express Logistic and Distribution EOOD nga British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i importit dhe tregtimit të duhanit të prodhuar nëpërmjet makinerive (FMC).
6. Vendimi nr. 468, datë 04.07.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 100% të ndërmarrjes Compal Electronics Europe spz.o.o. nga Compal Electronics B.V. tek Vestel Ticaret A.S”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua treg i prodhimit dhe shitjes të aparateve të televizorit LCD. Me qenë se në territorin e Shqipërisë nuk ka ndërmarrje, të cilat operojnë në tregun e prodhimit të aparateve të televizorëve LCD, treg përkatës produkti do të konsiderojmë vetëm tregun e shitjes të aparateve të televizorëve LCD.
7. Vendimi nr. 473, datë 14.09.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aseteve të ndërmarrjes Izi Mobil Telekomunikacije d.d. nga Telekom Slovenije d.d.”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shërbimeve të telekomunikacionit të lëvizshëm për klientët fundorë dhe tregu i aksesit me shumicë dhe origjinën e thirrjeve, në rrjetet publike të lëvizshme.



8. Vendimi nr. 480, datë 09.11.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të ndërmarrjes Jordan d.o.o. tek Telekom Slovenije d.d”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shërbimit roaming dhe shërbimet e telefonisë fikse me shumicë për inter-operatorët.
9. Vendimi nr. 486, datë 05.12.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të ndërmarrjes Fitzroy Merger CO, tërësisht e kontrolluar nga CTH Invest S.A. me Ferrara Candy Company Holdings Inc”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua: tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave prej çokollate; tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave në formë kremi; tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave me përmbajtje qumështi si snack të freskët dhe ëmbëlsira të ftohta dhe; tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave prej sheqeri.
10. Vendimi nr. 487, datë 05.12.2017 “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit mbi Portofolin e Kredisë së Procredit Bank AD Beograd nga Banca Intesa AD Beograd”. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shërbimeve bankare.

## 2.3 Tregjet e shërbimit / joprodhuese



### 2.3.1. Marrëveshjet e ndaluara

#### *Tregu me pakicë i shërbimeve celulare*

KK, me vendimin nr. 461, datë 23.05.2017 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, vendosi hapjen procedurës së hetimit paraprak për të parë nëse ka, shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas nenit 4 “Marrëveshjet e ndaluara” dhe nenit 9 “Abuzimi me pozitën dominuese” të ligjit nr. 9121/2003.

Pas vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve në treg dhe rolit të organeve shtetërore në rregullimin e tregut, përkatësisht AKEP dhe KMK, KK me vendimin nr. 475, datë 21.09.2017 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve”, vendosi:



Ti rekomandojë AKEP, si vijon:

1. Të njoftojë AK, për çdo paketë standarde/oferta të njoftuar nga ndërmarrjet që operojnë në tregun e telefonisë celulare që sjell efekte antikonkurruese në treg, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 12, nenin 38 dhe nenin 61 të ligjit nr. 9918/2008;
2. Të kërkojë opinionin e AK për çdo ndryshim të strukturës së tregut që mund të sjellë pasoja për konkurrencën;
3. Brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në bazë të nenit 70, të ligjit nr. 9121/2003, të marrë masat si vijon:
  - Të bëjë vlerësimin e paketave 28-ditore dhe 30-ditore për të vlerësuar nëse ka efekte negative për konsumatorin duke u shprehur me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it;
  - Ndryshimin e nenit 8, të rregullores nr. 27/2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, duke parashikuar detyrimin e ndërmarrjeve për njoftimin në AKEP, përpara bërjes efektive të miratimit të tarifave/ndryshimeve;
  - Të përcaktojë për operatorët e shërbimit celular, detyrimin që përveç çmimit të paketës standarde nga ana e ndërmarrjeve, të publikohet dhe çmimi për njësi për çdo shërbim (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB etj.), që këto paketa përmbajnë;
  - Të parashtrijë përpara AK, duke kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore për çdo rast për të cilin konstaton sjellje antikonkurruese nga ana e ndërmarrjeve, që ushtrojnë veprimtari në tregun e komunikimeve elektronike;
  - Të kryejë analiza për zhvillimin dhe orientimin drejt kostos së tarifave standarde të aplikuara për përdoruesit me parapagesë, që përdorin tarifatat standarde jashtë ofertave për operatorët me fuqi të ndjeshme në këtë treg.

T'i rekomandojë KMK, si vijon:

1. Të kërkojë nga ana e operatorëve të telefonisë celulare përmbushjen e detyrimit që për çdo ndryshim apo hedhje të paketave të reja në treg, që ka efekt të drejtpërdrejtë te konsumatori, të kërkojë transparencë çmimi për njësi për çdo shërbim të ofruar (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB etj.);
2. Ndërmarrjet që operojnë në tregun e telefonisë celulare, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të marrin masa për aplikimin dhe publikimin e çmimit për njësi për çdo shërbim (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB etj.) që përmbajnë paketat standarde, duke informuar AK;
3. Monitorimin nga ana e AK, të tregut me pakicë të shërbimeve celulare për një periudhë 1 (një)-vjeçare, e cila fillon nga data 1 tetor 2017.

4. Gjatë periudhës së monitorimit, ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në këtë treg, duhet të njoftojnë paraprakisht pranë AK të gjitha ndryshimet e kryera në paketa standarde, oferta promovionale, tarifa standarde etj., që do të hedhin në treg;
5. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.

AK është duke monitoruar zbatimin e këtij vendimi nga ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në tregun me pakicë të shërbimeve celulare si dhe zbatimin e rekomandimeve nga AKEP dhe KMK.

### *Spektori bankar*

KK, pas shqyrtimit të raportit të monitorimit në tregun bankar, me vendimin nr. 373, datë 16.09.2015, në zbatim të nenit 41, të ligjit nr. 9121/2003 hapi procedurën e "Hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar", për të vlerësuar nëse konkurrenca në këtë sektor është e kufizuar ose e shtrembëruar, si pasojë e sjelljes së një ose disa bankave. Ky hetim, ka synuar të vlerësojë konkurrencën në sektorin bankar, identifikimin e problemeve që mund të sjellin kufizim të konkurrencës dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e mjedisit konkurrues në këtë treg jetik, për ekonominë shqiptare.

AK ka kërkuar komente dhe sugjerime nga BSH dhe SHSHB mbi raportin "Hetim i përgjithshëm në sektorin bankar". Në përgjigje të kërkesës së AK, BSH dhe SHSHB, kanë paraqitur opinionet dhe komentet e tyre, lidhur me raportin e AK "Hetim i përgjithshëm në sektorin bankar".

Gjithashtu, në zbatim të nenit 70 të ligjit nr 9121/2003, me datë 09.02.2017 u zhvillua një tryezë e rumbullakët me përfaqësues të BSH, SHSHB dhe MZHETTS.

KK me vendimin nr. 453, datë 07.03.2017 "Për dhënien e disa rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe bankat e nivelit të dytë", vendosi:

T'i rekomandojë BSH:

1. Rishikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit midis BSH dhe AK, ku të përfshihet: Një kapitull i veçantë për rregullimin e konkurrencës në tregjet bankare, në të cilin të përcaktohet mënyra e bashkëpunimit midis dy institucioneve, në lidhje me çështje të konkurrencës në tregun bankar.
2. Reformulimin e pikës 4, të nenit 9, të rregullores së Bankës së Shqipërisë "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare" si vijon: "Banka duhet të parashikojë në kontratën e llogarisë dhe të depozitës, mënyrën e njoftimit të klientit për ndryshimin e kushteve të punës. Para se të aplikojë ndryshimin, në kushtet e rinovimit të kontratës, banka të marrë pëlqimin e klientit".

3. Identifikimin dhe adoptimin e masave të mundshme, për uljen e kostove të transfertave në nisje dhe në mbërritje në monedhë të huaj, kryesisht euro dhe dollar amerikan, nga një bankë te një bankë tjetër brenda vendit. Kjo do të çojë në nxitjen e qarkullimit të monedhës së huaj në kanalet bankare dhe do të ndihmojë në uljen e përdorimit të parasë cash në ekonomi.
4. Stimulimin dhe promovimin e shërbimit e-banking nga BSH dhe bankat, me qëllim nxitjen e aftësisë konkurruese të konkurrentëve më të vegjël si dhe të hyrësve të rinj në sistemin bankar dhe rritjen e përfitimeve të këtij shërbimi nga klientët.
5. Identifikimin dhe marrjen e nismave për rregullimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor/rregullator, në bashkëpunim edhe me institucione të tjera përgjegjëse, me qëllim uljen në të ardhmen, të përdorimit të transaksioneve cash në ekonomi.

T'i rekomandojë SHSHB:

Ndërmarrjen e nismës për krijimin e “Kodit të Sjelljes” nga bankat e nivelit të dytë, që nuk e kanë ende një Kod të Sjelljes/Kod Etike dhe publikimin dukshëm të tij në faqen zyrtare dhe ambientet e bankës, me qëllim rritjen e transparencës së bankave në shërbimet dhe produktet që ato u ofrojnë klientëve.

T'i rekomandojë bankave të nivelit të dytë:

1. T'i mundësojnë klientit përzgjedhjen e vlerësuesit dhe të noterit në një listë të përzgjedhur të bankës, me qëllim rritjen e konkurrencës mes ofruesve të këtyre shërbimeve.
2. Nxitja e kartave lokale, që nuk kanë kosto të larta si kartat që emetohen nga skemat ndërkombëtare (MasterCard, apo Visa etj..) që do të mundësonin më shumë përdorim dhe pranim të pagesave, pasi kostot do të ishin më të ulta edhe për bankat rrjedhimisht, edhe për klientët.
3. Të krijojnë lehtësira për lëvizshmërinë e klientëve, duke ulur kostot "bllokuese" (kostot të cilat e detyrojnë klientin të qëndrojë pranë një banke si komisione për mbyllje llogarie, kosto administrative për klientin si kohë, rimbushje formularësh, përgatitje dokumentacioni, përdorimi i teknologjive të reja për të afruar më shumë lehtësi tek klientët) si dhe të rrisin transparencën, duke i bërë më të kuptueshme këto kosto për klientin, përfshirë edhe skedën e amortizimit të kredisë, e cila duhet të jetë në gjuhën shqipe, në të gjitha bankat dhe për të gjitha rastet.
4. Bankat të bashkëpunojnë me Policinë e Shtetit dhe Shoqëritë e Ruajtjes së Sigurisë Fizike, për të rritur sigurimin e transportit të vlerave monetare brenda dhe për jashtë vendit.

AK ka monitoruar zbatimin e vendimit të KK, nga ku rezultoi se:

- BSH me anë të vendimit nr. 25, datë 03.05.2017 “Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”, ka pasqyruar rekomandimin e dhënë nga KK, konkretisht me

ndryshimin e pikës 4, të nenit 9 të rregullores së mësipërme, ku parashikohet që “Bankat, në rastet kur ndryshojnë kushtet e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve bankare apo financiare, të njoftojnë në mënyrë individuale secilin klient që është subjekt i këtyre ndryshimeve, të afishojnë njoftimet ose broshurat në ambientet e bankës, në faqen zyrtare të internetit ose me mjetet e komunikimit masiv. Ky njoftim të kryhet të paktën 15 ditë përpara se ndryshimet të bëhen të aplikueshme”.

- Bankat e nivelit të dytë (FiBank, Procredit Bank, Credins Bank, Banka e Bashkuar, Union Bank, Raiffeissen Bank dhe Intesa San Paolo Bank) në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga AK, kanë marrë përsipër përmbushjen e këtyre rekomandimeve, në përputhje edhe me kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. Bankat e mësipërme janë shprehur se nuk kanë klauzola ekskluziviteti, në lidhje me këtë shërbim për klientët. Klientët janë të lirë të zgjedhin nga një listë vlerësuesish dhe noterësh, që bankat jua vënë në dispozicion.
- Për nxitjen e kartave lokale, Procredit Bank, Credins Bank, Tirana Bank, Banka e Bashkuar, Raiffeissen Bank, Intesa San Paolo Bank kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të qenë pjesë e infrastrukturës, që do të pranojë kartat lokale. Ndërsa Union Bank shprehet se i aplikon kartat lokale.
- Në lidhje me rekomandimin e tretë, për të krijuar lehtësira për lëvizshmërinë e klientëve duke ulur kostot "bllokuese", Procredit Bank, Credins Bank, Tirana Bank, Banka e Bashkuar, Raiffeissen Bank, Intesa San Paolo Bank, Union Bank janë shprehur se respektojnë rregulloren e transparencës të BSH dhe kontratat e kredisë apo shërbimeve bankare, janë hartuar në mënyrë transparente.
- Bankat janë shprehur se bashkëpunojnë me Policinë e Shtetit, brenda kompetencave që i lejon kuadri ligjor e rregullator dhe bashkëpunojnë me shoqëritë e ruajtjes dhe sigurisë fizike, lidhur me transportin e vlerave monetare.
- Në lidhje me rekomandimin drejtuar SHSHB për krijimin e “Kodit të Sjelljes” nga bankat e nivelit të dytë, që nuk e kanë ende një Kod të Sjelljes/Kod Etike dhe publikimin dukshëm të tij në faqen zyrtare dhe ambientet e bankës, me qëllim rritjen e transparencës së bankave në shërbimet dhe produktet që ato u ofrojnë klientëve, është konstatuar se nga SHSHB është ndërmarrë kjo nismë dhe aktualisht 11 (njëmbëdhjetë) banka e kanë të publikuar kodin e etikës, në faqen zyrtare dhe ambientet e bankës, si dhe 5 (pesë) banka të tjera janë në proces rishikimi për publikim.

AK vazhdon ta ketë nën monitorim zbatueshmërinë e këtij vendimi.

### **2.3.2. Abuzimi me pozitën dominuese**

*Tregu i shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit*

Pranë AK, ndërmarrja “Albanian Stevedoring Company” Shpk, (ASC) depozitoi Formularin e Ankesës nëpërmjet të cilit kjo shoqëri ankohet kundrejt ndërmarrjeve: “EMS-Albanian Port Operator (EMS APO)” Shpk, “German Albanian Logistic Agency” Shpk (“Gala”), si dhe shoqërisë “EMS Shipping&Trading” GmbH (“EMS”).

KK, pas shqyrtimit të raportit mbi vlerësimin ankesës së Shoqërisë ASC të përgatitur nga Sekretariati i AK, në mbështetje të nenit 42, pika 1, nenit 9 dhe nenit 24 (shkronja d), të ligjit nr. 9121/2003 me vendimin nr. 450, datë 28.02.2017 vendosi: hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit, për periudhën kohore nga dita e nesërme e nënshkrimit të Kontratës Koncesionare, datë 6 Maj 2013, me objekt “Menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Terminalit Lindor në Portin e Durrësit”, me palë “EMS Shipping & Trading GmbH” dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, deri më datë 28.02.2017.

Gjithashtu, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga kontratat/licencë, të lidhura ndërmjet operatorëve stivadore dhe APD, parimit të portit të hapur “common user port”, sipas të cilit duhet t’i garantohet e drejta çdo përdoruesi të portit, të përzgjedhë operatorin e tij; detyrimeve të Koncesionarit në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, KK vlerësoi se mund të ndodhemi përballë një situatë urgjence, të parashikuar në nenin 44, të ligjit nr. 9121/2003, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 (abuzimi me pozitën dominuese) të këtij ligji.

Bazuar sa më sipër, KK, me vendimin nr. 451, datë 28.02.2017 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit”, vendosi marrjen e masave të përkohshme ndaj ndërmarrjes “EMS APO”, si vijon:

- Të zbatohet në mënyrë të menjëhershme detyrimin ligjor për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe shërbimet e lidhura me to, për të gjithë operatorët e licencuar stivadorë, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas licencës;
- Të lejojë aksesin e operatorëve stivadorë, të licencuar në Terminalin Lindor për të kryer shërbimet ndaj klientëve;
- “EMS APO” të vendosë në përdorim vinçat për të gjitha shoqëritë stivadore.
- Masat e përkohshme, merren për një periudhë kohore të caktuar deri në përfundim të hetimeve.

Në përfundim të hetimit paraprak, KK konkludoi se: sjellja e ndërmarrjes me pozitë dominuese EMS APO, duke vendosur kushte të padrejta tregtimi dhe refuzuar aksesin në

facilitetet e infrastrukturës, që disponon ndaj ndërmarrjeve stivadore, në zbatim të nenit 9, pika 2, gërmat a) dhe c) të ligjit nr. 9121/2003, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese, me pasoja të rënda për konkurrencën në treg.

KK, me vendimin nr. 477, datë 12.10.2017 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” Shpk, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit.

Pas përfundimit të raportit të hetimit të thelluar nga Sekretariati, një kopje i është dërguar ndërmarrjes EMS APO. Pas konsultimit me dosjen e hetimit, kjo ndërmarrje ka paraqitur prapësimet e saj me shkrim, lidhur me konkluzionet e raportit dhe është paraqitur në seancë dëgjimore sipas nenit 39, të ligjit nr. 9121/2003.

Gjithashtu një kopje e Raportit të hetimit të thelluar, iu dërgua MIE dhe APD, për t’u shprehur lidhur me konkluzionet e raportit. APD depozitoi vlerësimin e saj me shkrim dhe u paraqit në seancën dëgjimore të realizuar nga KK, ndërsa MIE, me gjithë kërkesat e vazhdueshme, nuk ka bashkëpunuar me AK dhe nuk ka marrë pjesë në seancë dëgjimore.

Për këtë arsye, AK, me shkresën nr.64 prot., datë 30.01.2018 i është drejtuar Komisionit të Ekonomisë dhe Financave dhe Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, në Kuvendin e Shqipërisë, duke depozituar Raportin Hetimor të realizuar për këtë çështje, për realizimin e një seance dëgjimore me MIE si organi rregullator në tregun përkatës. Në përfundim të kësaj procedure, KK do të shprehet me vendim përfundimtar në lidhje me rivendosjen e konkurrencës dhe rregullimin e këtij tregu.

#### *Tregu i shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës*

KK, pas shqyrtimit të raportit të monitorimit mbi tregun e distribucionit dhe shfaqjes së filmave për ndërmarrjet “Empire” Shpk (Empire), “Millenium” Shpk (Millenium) dhe “Cineplexx” Shpk (Cineplexx), në zbatim të nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 me anë të vendimit nr. 466, datë 20.06.2017 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e distribucionit dhe shfaqjes së filmave në rrjetet e kinemave në Tiranë”, vendosi hapjen e hetimit për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën nga 01.01.2015 deri në 30.06.2017.

Duke marrë parasysh: pjesët e tregut përkatës të ndërmarrjeve; pengesat në hyrje në tregun përkatës; fuqinë ekonomike financiare; karakteristikat e tjera të tregut përkatës si homogjenitetin e produkteve; transparencën e tregut; kapacitetet e lira dhe risitë; bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, rezultoi se ndërmarrja Cineplexx, ka pozitë dominuese në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës.

Nga krahasimi i çmimit mesatar të biletave të shfaqjes së filmit në kinema (benchmark rajonal) rezultoi se krahasuar me vendet e rajonit si Podgorica, Shkupi, Beogradi dhe Zagrebi, Shqipëria e ka çmimin e biletës më të ulët se mesatarja e çmimit të biletës së

rajonit dhe pak më të ulët se çmimi i biletave të rrjetit Cineplexx në rajon, çfarë tregon se në Shqipëri ndërmarrja Cineplexx nuk operon nëpërmjet vendosjes së çmimeve të larta, në kushtet kur kemi një ndërmarrje me pozitë dominuese.

Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese, Cineplexx, në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës, bazuar në rezultatin financiar të ndërmarrjes, krahasimi me çmimet e rajonit (benchmark rajonal) dhe çmimet e rrjetit Cineplexx në rajon, si dhe çmimet me konkurrentët e tjerë në vend, rezultoi se nuk vërehen shenja të abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes Cineplexx, në kuptim të nenit 9, të ligjit nr. 9121/2003.

Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, si pjesët e tregut, volumet e shitjeve, krahasimi i çmimeve të shitjes së biletave midis konkurrentëve dhe rezultati financiar negativ, nuk u vunë re shenja të koordinimit të sjelljes (marrëveshjes) midis ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003. Pra, mund të themi që nuk jemi para rastit të një kufizimi të konkurrencës për marrëveshje apo praktikë të bashkërenduar.

Megjithëse nuk u vunë re shenja të kufizimit të konkurrencës, në tregun përkatës ushtron veprimtari një ndërmarrje me pjesë të konsiderueshme dhe me fuqi tregu në rritje, Cineplexx, prandaj është e nevojshme mbikëqyrja e sjelljes së saj në vazhdimësi për të analizuar kushtet e tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, në kuptim të nenit 28, të ligjit nr. 9121/2003.

KK me vendimin nr. 479, datë 26.10.2017 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës”, vendosi:

- Për të analizuar kushtet e tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, ndërmarrja me pozitë dominuese “Cineplexx” Shpk, çdo 6 muaj, përkatësisht brenda datave 10 prill dhe 10 tetor të çdo viti, duhet të dërgojë pranë AK informacion mbi çmimet e shitjes së biletave, kostot përkatëse dhe brenda datës 10 prill, të dërgojë një kopje të pasqyrave financiare të vitit të mëparshëm, së bashku me shënimet shpjeguese të pasqyrave analitike financiare;
- Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 4 dhe nenit 9, të ligjit nr. 9121/2003.

Lidhur me vendimin e mësipërm të KK, janë njoftuar ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në tregun përkatës dhe ndërmarrja “Cineplexx” Shpk duhet të dërgojë informacion pranë AK çdo 6 (gjashtë) muaj, përkatësisht në datat 10 prill dhe 10 tetor. Pas dërgimit të informacionit nga ndërmarrja me pozitë dominuese “Cineplexx” Shpk, do të kryhet vlerësimi i kushteve të tregut për zhvillimin e konkurrencës.



*Tregu i tregtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumërave për bukë dhe nënproduktet e saj*

AK, në bazë të neneve 8, 9 dhe 29, pika 1 të ligjit nr. 9121/2003 shqyrtoi ankesën e z. H. C. dhe znj. L. C. ndaj ndërmarrjes “Nelly” Shpk për mosfurnizimin me produktet “Zrnopan T”, “Zrnopan S” dhe “Zrnopan Plus”.

KK, pas vlerësimit të ankesës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003, me anë të vendimit nr. 462, datë 23.05.2017 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumërave për bukë dhe nënproduktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” Shpk, vendosi hapjen e hetimit për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën nga 01.01.2017 deri në 15.05.2017.

Nga vlerësimi i të dhënave, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, rezultoi se nuk plotësohet kriteri kryesor i pozitës dominuese mbi pjesën e tregut. Bazuar në këtë kriter si dhe në kriteret e tjera, si fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjes, konkurrenca potenciale, rezultoi se ndërmarrja “Nelly” Shpk nuk zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës. Si rezultat, nuk jemi para rastit të një abuzimi të mundshëm me pozitën dominuese në tregun e majasë dhe tregun e produkteve përzierës me fara, për prodhimin e bukëve dhe simiteve Zrnopan T, S dhe Plus.

Pas vlerësimit të të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurës hetimore si: dokumentacionit të administruar gjatë inspektimeve, dokumentacionit të dorëzuar nga ndërmarrja nën hetim, dokumentacionit të sjellë nga DPD dhe AKU nuk u konstatuan elemente të abuzimit me pozitën dominuese në tregun e produkteve përzierës me fara për prodhimin e bukëve dhe simiteve, i ndarë në tre nëntregje dhe në tregun e produkteve të përdorura për ardhjen e brumit, majasë i ndarë në dy nëntregje, të parashikuara në nenin 9 të ligjit nr. 9121/2003.

KK me vendimin nr. 472, datë 14.09.2017 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e tregtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumërave për bukë dhe nënproduktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” Shpk”, vendosi:

- Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumërave për bukë dhe nënproduktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” Shpk, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 9, të ligjit nr. 9121/2003.

*Tregu i transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines*

Pranë AK, nëpërmjet formularit të ankesës nr. 423 Prot., datë 20.10.2017, u paraqit ankesa nga disa pasagjerë, lidhur me sjelljen e shoqërisë ajrore Austrian Airlines.



Sipas ankuesve, kjo shoqëri kishte ndryshuar itinerarin e udhëtimit dhe orarin e tij në momentin e fundit kur pasagjerët ishin paraqitur në aeroport, pa ndonjë paralajmërim paraprak. Gjithashtu, pavarësisht se rezervimi dhe prerja e biletës ishte bërë për të fluturuar me avion të shoqërisë Austrian Airlines, kjo shoqëri i detyroi udhëtarët të fluturonin në itinerare të tjera me avionë të linjave të tjera, duke mos marrë shërbimin e paguar.

Duke pasur parasysh ankesën e depozituar pranë AK, pozicionin e ndërmarrjes Austrian Airlines, e cila operon e vetme në linjën direkte Tiranë – Vjenë dhe anasjelltas, si dhe fuqinë që kjo ndërmarrje ka për vendosjen e kushteve të tregtimit, mund të jemi para një kufizimi të mundshëm të konkurrencës nga kjo ndërmarrje në treg, në kuptim të nenit 9, të ligjit nr. 9121/2003.

Referuar sa më sipër, KK me vendimin nr. 490, datë 20.12.2017 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines”, vendosi:

- Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines;
- Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2017 deri në 31 dhjetor 2017.

*Tregu i shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve*

Pranë AK, ndërmarrja “Skenderi G” Shpk depozitoi një ankesë lidhur me shërbimin e mirëmbajtjes së kasave fiskale për karburantet, për të cilin ka një kontratë me ndërmarrjen “AED” Shpk. Njëkohësisht, kjo ndërmarrje lidhur me problematikën me shoqëritë e autorizuara të pajisjeve fiskale AED dhe “Daisy & ETM”, të cilat kanë marrë përsipër për të ofruar të gjitha shërbimet e shoqërisë “CKV Noki Albania” Shpk, për shkak se kësaj shoqërie nuk iu rinovua Autorizimi nga ana e MFE.

Sipas ankuesit, nga ndërmarrja AED në mënyrë të njëanshme është njoftuar që për shkak të një detyrimi të prapambetur, referuar kontratë shitje për pajisje fiskale që në vitin 2010 nuk do të ofrohet asnjë shërbim i kërkuar për asistencë dhe mirëmbajtje, gjë e cila ka dëmtuar procesin e shitjes së karburantit, duke qenë se kasat fiskale dhe distributorët janë në regjim automatik në bazë të parimit “Pa kupon nuk ka karburant”.

Duke vlerësuar ankesën e depozituar pranë AK dhe pozicionin e ndërmarrjeve që ofrojnë shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve, të cilat janë të vetme për ofrimin e këtij shërbimi në treg, KK vlerësoi se mund të jemi para një kufizimi të mundshëm të konkurrencës nga këto ndërmarrje në treg, në kuptim të nenit 9, të ligjit nr. 9121/2003.

Referuar sa më sipër, KK me vendimin nr. 491, datë 28.12.2017 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve, për periudhën kohore nga 1 prill 2017 deri në 31 dhjetor 2017.

Nga hetimi, rezultoi se nuk përmbushen kushtet e refuzimit për të ofruar shërbimin në tregun përkatës, sipas nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

Në përfundim, KK me vendimin nr. 493, datë 23.01.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve”, vendosi:

- Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

*Tregu i furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar "Tirana International Aeroport"*

KK, në zbatim të nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 me vendimin nr. 417, datë 18.05.2016 “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Aeroport” vendosi hapjen e hetimit paraprak për periudhën nga data 01.01.2015 deri më 18.05.2016.

Pas realizimit të procedurës së hetimit paraprak, KK me vendimin nr. 432, datë 14.09.2016 “Mbi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant, në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Aeroport”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar.

Raporti i hetimit të thelluar, iu komunikua ndërmarrjes AIR BP Albania Sha dhe në zbatim të nenit 39, të ligjit nr. 9121/2003 dhe nenit 18, të rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, pala nën hetim, paraqiti pretendimet e saj mbi raportin e hetimit të thelluar me shkrim, të cilat janë marrë në konsideratë nga KK.

KK, pas vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese në tregun përkatës ABP Albania Sha, mbi dhënien e aksesit për palët e tjera të interesuara, për të ushtruar aktivitet pranë TIA, në kuptim të nenit 9, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 9121/2003, rezultoi se kjo ndërmarrje, për periudhën nën hetim, nuk ka kufizuar asnjë ndërmarrje për të ushtruar aktivitet në tregun përkatës.

KK, me vendimin nr. 116, datë 29.05.2009 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes midis “Tirana International Airport” Shpk dhe “AIR BP Albania” Sha “Për sigurimin e

depozitimit dhe tregtimit të karburantit për avionë, si dhe të shërbimit të furnizimit të avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza", ka vendosur:

Të përjashtojë nga ndalimi (i parashikuar në nenin 4, të ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës"), marrëveshjen e datës 24.02.2009 midis "Tirana International Airport" Shpk dhe "Air BP Albania" Sha "Për sigurimin e depozitimit dhe tregtimit të karburantit për avionë dhe të shërbimit të furnizimit të avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza".

Për sa më sipër, KK me vendimin nr. 470, datë 11.07.2017 "Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar "Tirana International Airport", vendosi:

Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar "Tirana International Airport".

Monitorimin e tregut për 1 (një) vit nga dalja e këtij vendimi, për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjes "Air BP Albania" Sha, në lidhje me kërkesat potenciale nga palët e interesuara për të hyrë dhe për të ushtruar aktivitetet në tregun përkatës.

Sekretariati i AK në vijim të monitorimit të vendimit të KK me shkresën nr. 367 Prot., datë 19.09.2017 ka kërkuar nga ndërmarrja "Air BP Albania" Sha informacion, nëse pranë saj janë paraqitur kërkesa nga palë të interesuara për të hyrë dhe për të ushtruar aktivitetet në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar "Tirana International Airport".

Ndërmarrja "Air BP Albania" Sha, me shkresën e saj datë 03.10.2017 ka depozituar pranë AK informacionin e kërkuar. Sipas ndërmarrjes "Air BP Albania" Sha, nga data e vendimit, nuk ka marrë kërkesë formale ose joformale për akses në pajisjet e saj në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

*Tregu i transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në Portin e Vlorës*

Pranë AK, ndërmarrja "Arkleand Bus" Shpk, e cila kryen aktivitetet në fushën e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus depozitoi Formularin Tip të Ankesës, kundrejt agjencive "Gerverni Travel" Shpk dhe "Euroferries" Shpk, përfaqësuese të shoqërisë së tragetit "Northbay Transportes Marittimos Lda", që operon në linjën Vlorë - Brindisi dhe anashjelltas.

Bazuar në ankesën e paraqitur, KK, në zbatim të nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 me anë të vendimit nr. 455, datë 28.03.2017 "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në Portin e Vlorës", vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve.

Shërbimi i transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në Portin e Vlorës për periudhën nën hetim është ofruar nga kompania "Northbay Transportes Marittimos" LDA, e përfaqësuar nga agjencia detare "G Travel" Shpk, si dhe nga shoqëria "EUROPEAN SEAWAYS" INC e përfaqësuar nga agjencia detare "RUCI LINE" Shpk, për vitin 2016 dhe "EUROPEAN SEAWAYS" Shpk, për vitin 2017. Shërbimi i transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në Portin e Vlorës, realizohet nëpërmjet mjeteve lundruese/trageteve në pronësi ose përdorim të kompanive të mësipërme, që operojnë në Portin Detar Vlorë në linjën Vlorë - Brindisi dhe anasjelltas.

Duke filluar nga data 22.02.2017 dhe në vazhdim, në Portin Detar Vlorë ka operuar vetëm kompania: "NTM Lda" me tragetin "St.Damian", përfaqësuar nga agjencia detare "G TRAVEL" Shpk, e cila realizon transportin ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve e vetme, duke mos pasur konkurrentë në këtë zonë gjeografike dhe duke zotëruar në këtë mënyrë 100 % të tregut përkatës.

Ankimuesi përpara përfundimit të hetimit paraprak, më datë 15.05.2017, kërkoi tërheqjen e ankesës së datës 27.02.2017, për shkak se situata ka ndryshuar dhe është tarifuar njëllë si kompanitë e tjera. Marrëdhëniet kontraktuale janë rivendosur në vullnet të lirë dhe draft-kontrata e propozuar nuk është konkluduar me firmosjen e saj dhe se sjellja e ndërmarrjes nën hetim është korrigjuar duke ofruar shërbimin e transportit të mjeteve dhe pasagjerëve nga/drejt Brindizit – Itali, me kushte të njëjta tregtimi për të gjitha shoqëritë e interesuara.

Pas tërheqjes së ankesës nga ana e ankimesit, për të vlerësuar kushtet e tregut, me datë 15.06.2017 u realizua një inspektim në Portin e Vlorës, nga ku rezultoi se situata ishte normalizuar dhe operatori i vetëm i tragetit iu ofronte shërbim të gjitha shoqërive të interesuara me kushte të njëjta tregtimi, duke e vendosur tregun në kushtet e konkurrencës të lirë dhe efektive dhe pa diskriminime në ofrimin e shërbimeve mes operatorëve, që përdorin linjën e transportit detar Vlorë - Brindisi.

Tregu i shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve ka qenë objekt monitorimi, hetimi dhe vendimmarrjeje nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, edhe me parë, ku janë dhënë dhe rekomandime për institucionet përkatëse, me vendimin e KK, nr. 349, datë 19.02.2015 "Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve".

Referuar sa më sipër, KK me vendimin nr. 467, datë 04.07.2017 "Për marrjen e disa masave për rregullimin e konkurrencës në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në Portin e Vlorës dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak", vendosi:

- Detyrimin e ndërmarrjes "Northbay Transportes Marittimos Lda", përfaqësuar nga "Gerverni Travel" Shpk, të zbatojë kushte të barabarta për veprime tregtare të njëjta me palët (shoqëritë e transportit rrugorë që përdorin transportin detar nga Porti i Vlorës), për t'i vendosur në gjëndje të favorshme konkurrence;
- Në rast të moszbatimit të pikës 1 të dispozitivit të këtij vendimi, ndërmarrjet ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të

konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma c) të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);

- Monitorimin e tregut të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në Portin e Vlorës, për periudhën nga data 04.07.2017 deri më 04.01.2018, me qëllim verifikimin e sjelljes së ndërmarrjes “Northbay Transportes Marittimos Lda” për zbatimin e detyrimit, të vendosur sipas pikës 1 të dispozitivit të këtij vendimi;
- T’i rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, që bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës, nr. 349, datë 19/02/2015 “Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”, të realizojë:
  - Monitorimin e zbatimit të tarifave sipas njoftimeve dhe miratimit të MTI për secilin traget/linjë, kryesisht gjatë sezonit të lartë;
  - Sigurimin e të dhënave të detajuara mbi të gjitha kostot reale për shërbimin që ofrojnë operatorët;
  - Monitorimin e mbajtjes së të dhënave ditore për tarifën e aplikuarë për çdo biletë të shitur, si dhe mbajtjes së rekordeve të shitjeve të biletave nga ndërmarrjet që operojnë në treg.
- Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në Portin e Vlorës.

Rekomandimet e dhëna për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës (sot MIE), nuk janë zbatuar në praktikë, pasi në kontratën e operatorëve me portin mungojnë dispozitat përkatëse lidhur me detyrimin e operatorëve për:

- depozitimin e kostove reale për shërbimin që ofrojnë;
- mbajtjen e të dhënave ditore për tarifën e aplikuarë për çdo biletë të shitur;
- mbajtjen e rekordeve të shitjeve të biletave nga ndërmarrjet që operojnë në treg.

Në përfundim rezulton se këto të dhëna nuk monitorohen dhe nuk mbikëqyren nga MIE, duke mos zbatuar rekomandimet e dhëna në vendimin e KK.

#### *Tregu i shërbimit funeral në Bashkinë Berat*

Pranë AK, u depozitua kërkesa-ankimore, datë 12.12.2016 me ankues Z. E.K. person fizik, e cila i drejtohet Bashkisë së qytetit Berat dhe për dijeni: AK; Këshillit Bashkiak Berat; dhe shoqërisë Soliar Shpk, me objekt mosfunksionimi i zhvillimit të aktivitetit funeral, si pasojë e një marrëveshjeje të ndaluar, që ka si objekt pengimin e konkurrencës.

Nga shqyrtimi i ankesës rezultoi se si rezultat i një procedure elektronike prokurimi, autoriteti kontraktor “Bashkia Berat” ka lidhur kontratën e shërbimit nr. 6150 prot., datë 10.11.2016, me objekt “Mirëmbajtje e varrezave publike dhe të varrezave Dëshmorët e Kombit Berat”, me operatorin ekonomik fitues “AB.Zoga” Shpk & “Pienvis” Shpk.

Referuar kontratës së shërbimit nr. 6150 prot., datë 10.11.2016, shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të Dëshmorëve të Kombit të Bashkisë Berat, konsiston në: ruajtjen e varrezave; pastrim prerje bari; ujitje bimësh dekorative; mirëmbajtje parcele ekzistuese; pastrim rruge e sheshe; rifreskim i germave të varrezave të dëshmorëve; pastrim varri prej mermeri në varrezat e dëshmorëve dhe në këtë objekt, nuk rezulton të jetë i përfshirë administrimi i shërbimit funeral dhe mbledhja e tarifave për këtë shërbim.


Për sa më sipër, Bashkia Berat i ka dhënë operatorit ekonomik "AB.Zoga" Shpk & "Pienvi" Shpk, të drejtën dhe detyrimin e lidhjes së kontratave për shërbimin funeral me subjektet e licencuara që e ofrojnë këtë shërbim, si dhe të zbatojë tarifat e vendosura me Vendimin e Këshillit Bashkiak për këtë shërbim, i cili është jashtë objektit të kontratës. Projekt Akt-Marrëveshja, objekt ankimimi i detyron palët e përfshira në këtë marrëveshje, "SOLIAR" Shpk dhe E.K. (Ankimuesi), që të lidhin një marrëveshje me subjektin "AB ZOGA" Shpk, subjekt i cili gjithashtu operon në të njëjtin treg përkatës si edhe dy subjektet e tjera.

KK me vendimin nr. 447, datë 16.01.2017 "Për dhënien e disa rekomandimeve Bashkisë Berat për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit funeral", vendosi:

- T'i rekomandojë Bashkisë Berat: "Hapjen e tregut për konkurrencë të lirë në shërbimin e punimeve funerale, duke vendosur kriteret e njëjta për të gjithë operatorët që ofrojnë këtë shërbim."

Nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë jemi njoftuar nëpërmjet fletë-thirrjes, për të marrë pjesë në proces, si palë e tretë e interesuar.

## 2.4 Tregjet prodhuese



### 2.4.1. Marrëveshjet e ndaluara

*Tregu i importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes*

Në datën 1 janar 2017, hynë në fuqi ndryshimet në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohet vendosja e akcizës për kategorinë GLN, vetëm për automjetet në vlerën 8 lekë/litër pa T.V.Sh. Nga monitorimi u konstatua se ka subjekte që tregtojnë me të njëjtin çmim. Kjo sjellje mund të përbëjë shenja të një kufizimi të konkurrencës në shkelje të neneve 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003.

Për më sipër, KK me vendimin nr. 446, datë 16.01.2017 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes”, vendosi:

- Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën kohore nga 01.07.2016 deri në përfundim të periudhës së hetimit.

Pas kryerjes së procedurave të hetimit paraprak dhe pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave hetimore në treg, u konstatua se:

- Ndërmarrjet importuese dhe shitëse me shumicë "A&V Gas" Sha dhe "Kevin Gaz" Sha, kanë një sjellje të bashkërenduar, përse i përket çmimit të shitjes me shumicë të GLN dhe ndarjes gjeografike të burimeve të furnizimit, çka mund të përbëjë një praktikë të bashkërenduar/marrëveshje të ndaluar, në shkelje të nenit 4, pika 1 të ligjit nr. 9121/2003.
- Mesatarja e diferencës çmim blerje - çmim shitje për periudhën objekt hetimi është shumë e ngushtë dhe thuajse simetrike, duke paraqitur sjelljen e njëjtë që kanë ndërmarrjet "A&V Gas" Sha dhe "Kevin Gaz" Sha, gjë e cila në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, mund të përbëjë një praktikë të bashkërenduar/marrëveshje të ndaluar midis këtyre 2 (dy) ndërmarrjeve.
- Në të gjithë strukturën e funksionimit të tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të GLN nga zona e Porto Romanos kemi ndërmarrje të integruara vertikalisht, e cila rrit fuqinë e këtyre ndërmarrjeve dhe mund të çojë në kufizime të konkurrencës, në zbatim të ligjit nr. 9121/2003.

Për sa më sipër, KK me vendimin nr. 454 , datë 21.03.2017 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës për konsum familjar dhe biznes, për ndërmarrjet si vijon: "Romano Port" Sha, "Ib Gas Ag", "Inter-Gaz" Sha, "A&V Gas" Sha, "Av Distribution" Sha; "La Petrolifera Italo Albanese" Sha,



"Fam Gas", "Kevin Gaz" Sha dhe "Emanuel Gas" Shpk., për periudhën kohore maj 2015 deri shkurt 2017.

Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave të hetimit në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës, për konsum familjar dhe biznes, rezulton se:

- Nuk u gjetën evidenca direkte, për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve, sipas nenit 4, të ligjit nr. 9121/2013. Gjithashtu, sjellja e ndërmarrjeve ndaj çmimit të shitjes, duke aplikuar çmime të ndryshme me diferenca domethënëse për këtë treg, nuk përbën shenja të kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 3, pika 4 dhe nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, si dhe Metodologjisë së OECD "Për zbulimin e karteleve me evidenca indirekte" në formën e një marrëveshje të ndaluar/praktike të bashkërenduar, midis këtyre ndërmarrjeve;
- Referuar pasqyrave financiare, treguesit EBITDA (të ardhurat përpara zbritjes së interesave, taksave dhe amortizimit) për periudhën 2013 - 2015 dhe marzhet bruto të të ardhurave për periudhën objekt hetimi, tregojnë se nuk jemi përpara normave të fitimeve jonormale ose ekseseve, të cilat janë tregues të një tregu që vuan nga mungesa e konkurrencës;
- Në nivelin e tregimit me shumicë, kokludohet se nuk jemi para çmimeve të fiksuara në shitje, në këtë nivel tregtimi. Çmimet e shitjes variojnë nga njëra ndërmarrje tek tjera, por duke ndjekur trajektoren e çmimeve të rritura të shitjes, transferuar nga çmimet e bursës ndërkombëtare të karburanteve PLATZ tek importuesit edhe më pas, te kjo kategori tregtimi.

Në përfundim, nga hetimi rezultoi se nga ndërmarrjet nën hetim nuk ka shkelje të ligjit nr. 9121/2013, si dhe rekomandimet e dhëna me vendimin e KK nr. 390, datë 22.12.2015 "Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës dhe dhënien e rekomandimeve për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë" nuk janë vënë në veprim nga Ministria.

Për këto arsye, KK me vendimin nr. 476, datë 05.10.2017 "Për zbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 390, datë 22.12.2015 dhe mbylljen e hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes", vendosi:

T'i rekomandojë Operatorit Shtetëror të Autorizuar, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave:

- Miratimin e një metodologjie për rregullimin e tregut e cila të përcaktojë në mënyrë të qartë rolin, funksionet dhe mënyrën e funksionimit të çdo operatori që vepron në fushën e importit, ngarkim-shkarkimit, depozitimit, shitjes me shumicë, shitjes me pakicë dhe shpërndarjes së gazit të lëngshëm natyror;



- Zbatimin e vendimit të KK nr. 390, datë 22.12.2015 dhe rekomandimeve të dhëna si vijon:
  - Të ndërmarrë veprimet e nevojshme për mirëfunksionimin e segmenteve të tregut të importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN në përputhje me nenet 14, 15 dhe 16 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.
  - Të ndalojë ndërmarrjet e shitjes me shumicë të GLN, të shesin me pakicë te klientët fundorë të cilët nuk janë të përfshirë në nenin 14 të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999.
  - Të ndalohen ndërmarrjet e tregtimit me pakicë të GLN, që të tregtojnë produkt për njësi të tjera që kanë si objekt rishitjen e këtij produkti siç parashikohet në nenin 16 të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999. Njësitë e shitjes me pakicë të GLN, duhet të tregtojnë produkt vetëm për konsumatorët fundorë.

Ndërmarrjet nën hetim, Operatori Shtetëror i Autorizuar dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të njoftojnë pranë AK, mbi zbatimin e rekomandimeve të mësipërme brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Monitorimin nga ana e AK, të të gjitha segmenteve të tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes, për një periudhë 1-vjeçare, e cila fillon nga data 16 tetor 2017.

Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes.

AK ka monitoruar në terren tregun përkatës dhe ka vlerësuar se për periudhën mars-tetor 2017 nuk u vunë re shenja të kufizimit apo shtrembërimit të konkurrencës, të parashikuara në nenet 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003. Situata në treg është e njëjtë me atë të konstatuar gjatë periudhës së hetimit të thelluar dhe nuk ka asnjë reagim nga organet shtetërore lidhur me zbatimin e rekomandimeve.

Në vijim të monitorimit do të kërkohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zbatimi i rekomandimeve të dhëna sipas pikës I të vendimit Nr. 476, datë 05.10.2017 të Komisioni i Konkurrencës, pasi nuk është respektuar afati 90-ditor nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi.

#### **2.4.2. Abuzimi me pozitën dominuese**

*Tregu i shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*

Vendimi nr. 47/2017 i ERRU mbi miratimin e tarifave për periudhën 01.01.2018 e në vazhdim, u vlerësua nga AK në kuadrin e rolit të tij në rregullimin dhe reformën rregullatore sipas nenit 70, të ligjit nr. 9121/2003. KK me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, vendosi:

T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit:

- Detyrimin për zbatimin e neneve 69 dhe 70, të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ, që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës;
- Për çdo rast të rishikimit të tarifave të reja për ndërmarrjet e ujësjellës kanalizime, të përcaktohet qartë struktura e kostos mbi bazën e së cilës miratohen tarifat, bazuar në metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura”, në të cilën përfshihen kostot e:
  - Tarifës së ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve;
  - Tarifës për shërbimin e grumbullimit, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura;
  - Tarifës së shërbimit.
- Rritja e tarifave duhet të jetë graduale dhe në përputhje me kriteret e performancës, në mënyrë të veçantë të orarit të furnizimit me ujë;
- Të rishikohen kostot në drejtim të rritjes së performancës së administrimit dhe të rishpërndahen burimet e të ardhurave, të kërkuara për investime edhe nga ulja e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, pasi sipas vendimit, të ardhurat do të vijnë në masën 96% nga rritja e tarifave dhe vetëm 4% nga rritja e nivelit të faturimit;
- Publikimin dhe bërjen transparente, brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi, të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të cilat bazohen këto ndryshime, si dhe për vitet 2018 dhe 2019 të publikohen treguesit e parashikuar për “ujin pa të ardhura”, “kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “eficiencën e stafit”.

T’i rekomandojë UKT që:

- Aksionarët e UKT, për ta bërë tregun sa më eficient, duhet të vlerësojnë mënyrat alternative të financimit të nevojave financiare të UKT, nëpërmjet kredive të buta/të lehtësuara ose nëpërmjet obligacioneve të qeverisjes vendore sipas ligjit nr. 10 158, datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”.

### *Tregu i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.*

Nisur nga disa artikuj të publikuar në median e shkruar dhe vizive në datat 22-24 nëntor 2017, është konstatuar përsëri se ndërmarrja “Mika Korça” Sha, si grumbulluesi kryesor në vend, nuk ka shlyer kultivuesit e duhanit në zonën e Belshit/Dumresë. Kultivuesit e Belshit ankohen se kanë shuma të mëdha parash pa marrë edhe pse kanë kontratë me këtë ndërmarrje. E njëjta situatë është dhe për kultivuesit e zonës së Shkodrës dhe Korçës.

AK ka realizuar procese monitorimi dhe hetimi në këtë treg, dhe me vendimin nr. 438, datë 05.10.2016, ka vendosur t'i rekomandojë Ministrisë së Bujqësisë:

- Marrjen e masave për hapjen e tregut të grumbullimit të duhanit të prodhuar në vend, për të nxitur zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në këtë treg;
- Asistencën e specialistëve të Ministrisë së Bujqësisë gjatë procesit të kategorizimit të duhanit sipas cilësisë dhe vendosjes së çmimeve përkatëse, të përcaktuara në kontratat midis palëve gjatë grumbullimit në stacionet e caktuara në vend;
- Monitorimin e realizimit të pagesave nga ana e ndërmarrjes “Mika Korça” Sha, brenda afateve të parashikuara në kontratën e lidhur nga kjo ndërmarrje me fermerët.

Megjithatë, referuar njoftimeve në media, situata në treg mbetet e njëjtë, pra shoqëria nuk ka shlyer ende kultivuesit për prodhimin e dy viteve të fundit 2015 – 2017, në zonën e Belshit/Dumresë, e cila është zona më e madhe e prodhimit të duhanit në vend.

Pozicioni që ndërmarrja “Mika Korça” Sha ka në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit të prodhuar në vend, si ndërmarrja kryesore e cila grumbullon duhan me destinacion eksportin e këtij produkti, fuqia që kjo ndërmarrje ka për vendosjen e çmimeve të blerjes, si dhe sjellja e saj e vazhdueshme kundrejt fermerëve, përbënë indicio se mund të ishim para një abuzimi të mundshëm me pozitën dominuese të kësaj ndërmarrjeje në treg, në kuptim të nenit 9, të ligjit nr. 9121/2003 .

Për këto arsye, KK me vendimin nr. 488, datë 05.12.2017 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit”, vendosi hapjen e hetimit paraprak për periudhën kohore nga 01. 06. 2016 deri në 30. 11.2017.

Kjo procedurë është në fazën e përpunimit të informacionit të administruar dhe hartimit të raportit me gjetjet e hetimit.

### *Tregu i gazit natyror*

ERE gjatë vitit 2017, ka dërguar për opinion pranë AK projekt aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e Gazit Natyror”. Nga shqyrtimi i projekt – akteve të ardhura dhe në zbatim të neneve 9, 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, KK u shpreh me vendimet e listuara më poshtë :

1. Vendimin nr. 469, datë 11.07.2017 “Për rekomandime në lidhje me certifikimin paraprak të Shoqërisë-Operatorit të kombinuar të Gazit Natyror, Albgaz Sha”, me anë të të cilit u vendos: t’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë:

- Të dizenjojë dhe të çojë për miratim pranë Këshillit të Ministrave Modelin dhe Rregullat e Tregut të Gazit Natyror në Shqipëri, ku të parashikohen mënyra e organizimit, funksionimit dhe ndërveprimit mes Operatorit të Kombinuar të gazit natyror Albgaz Sha me OST, OSSH, Prodhim, Impiantet e Përpunimit, Furnizimit, Depozitimit dhe operatorëve të tjerë;
- Në miratimin paraprak të Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror Albgaz Sha, të parashikohet ndarja e llogarive për secilën nga veprimtaritë e tij.

2. Vendimin nr. 481, datë 16.11.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë, në lidhje me kushtet e licencës së aktivitetit të shpërndarjes së gazit natyror”, me anë të të cilit u vendos: t’i rekomandojë ERE:

Në draft-licencën e operatorit të shpërndarjes së Gazit Natyror, të parashikohet raportimi i vazhdueshëm nga ana e të licencuarit dhe monitorimi i vazhdueshëm mbi realizimin e investimeve të planifikuara, duke parashikuar sanksione në rast mosrealizimi.

- Në parashikimet e pikës 4.10 të draft-licencës, lidhur me kompanitë vertikalisht të integruara, të përfshihen në draft – licencë të gjitha parashikimet ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si edhe parashikimet e nenit 26 “Unbundling of distribution system operators” të direktivës 73/2009/EC, datë 13.07.2009 “Lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror”.
- Të përcaktohet në draft licencë detyrimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së gazit natyror, që të publikojë të gjitha të dhënat lidhur me tregun e shpërndarjes, të cilat ndihmojnë operatorët e tregut dhe përdoruesit e rrjetit, për të patur gjithë informacionin e nevojshëm, për rrjetin e shpërndarjes në tregun e gazit natyror.
- Në pikën 4 të draft-licencës, të parashikohet ndarja e pronësisë, në rast se operatori është ndërmarrje vertikalisht e integruar.


3. Vendimin nr. 482, datë 16.11.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë, në lidhje me kushtet e licencës së aktivitetit të furnizimit të gazit natyror”, me anë të të cilit u vendos: t’i rekomandojë ERE:

- Licencimi për veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror, të kryhet pasi/ose paralelisht me miratimin e Modelit të Tregut të Gazit Natyror, të parashikuar edhe në nenin 88 të ligjit “Për Sektorin e Gazit Natyror”, në mënyrë që të dalin qartë kushtet e operimit, roli dhe funksioni i operatorit apo operatorëve të furnizimit;
- Në pikën 3 (2) (a) të draft-licencës, të përcaktohet afati i ndryshimit të furnizuesit “të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, jo më shumë se 3 javë nga fillimi i procedurës për ndryshim të furnizuesit” dhe sipas

parashikimeve ligjore të nenit 3(6)(a) të Direktivës 73/2009/EC të datës 13.07.2009 “Lidhur me rregullat e përbashkët për tregun e brendshëm të gazit natyror”;

- Në pikën 3.4 të draft-licencës, të shtohet një paragraf ku të përcaktohet: “I licencuari, i ngarkuar sipas ligjit me detyrimin për sigurimin e shërbimit të furnizimit me gaz natyror, u siguron klientëve dhe ndërmarrjeve të gazit, të dhëna mbi tregun e gazit natyror, konsumin e gazit natyror, duke i publikuar njëkohësisht këto të dhëna, të cilat janë të vlefshme për operatorët e tregut” sipas parashikimeve ligjore të nenit 3(12) të Direktivës 73/2009/EC, të datës 13.07.2009 “Lidhur me rregullat e përbashkët për tregun e brendshëm të gazit natyror”.
  - Në pikën 4.1 të shtohet paragrafi: “faturat e shpenzimeve për çdo aktivitet të të licencuarit, të jenë lehtësisht të dallueshme se cilit aktivitet i përket, pra faturat të kenë shenja dalluese të qarta sipas përkatësisë së aktivitetit të licencuara që janë përdorur, me qëllim që të shmangen mbivendosjet e shpenzimeve apo regjistrimet e dyfishta, për aktivitetet e të licencuarit”.
4. Vendimin nr. 483, datë 16.11.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me kushtet e licencës së aktivitetit të tregtimit të gazit natyror”, me anë të të cilit u vendos: t’i rekomandojë ERE:
- Licencimi i aktivitetit të tregtimit të kryhet pasi/ose paralelisht me miratimin e Modelit të Tregut të Gazit Natyror, të parashikuar në nenin 88, të ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, mbi bazën e të cilit do të përcaktohen nivelet e tregtimit të Gazit Natyror;
  - Në draft – licencë duhet të përcaktohet qartë roli dhe funksioni i tregut primar dhe tregut sekondar, tregut me shumicë dhe tregut me pakicë, sipas parashikimeve të nenit 4 (109) (110) dhe nenit 84(1)(2)(3)(4), të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe roli dhe funksioni i operatorit që do të kryejë aktivitetin e tregtimit në Modelin e Tregut të Gazit Natyror;
  - Në draft-licencë duhet të përcaktohet afati i vlefshmërisë së licencës, të parashikuar në nenin 23 pika 1(a) e ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”;
  - Në pikën 3.6 të draft-licencës të parashikohet mbajtja e llogarive të ndara për gjithë aktivitetet e licencuara të operatorit”.

Rekomandimet e dhëna sipas neneve 69 dhe 70




## PJESA E TRETË

### AUTORITETI I KONKURENCËS PËRBALLË PROCESEVE GJYQËSORE

Gjatë vitit 2017 janë dhënë 47 vendime nga Komisioni i Konkurrencës nga të cilat vetëm 1 (një) prej tyre është ankimuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, konkretisht vendimi i KK nr. 451, datë 28.02.2017 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho, në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit”.

#### Numri i çështjeve në të tre shkallët e gjyqësorit, gjatë vitit 2017



#### 3.1 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë (2017)

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, gjatë vitit 2017 janë gjykuar 3 (tre) çështje, në të cilat AK është palë si e paditur në 2 (dy) raste dhe si paditës në 1 (një) rast:

1. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “EMS APO”, të paditur AK, me objekt: “Shfuqizimi i vendimit të KK nr. 451, datë 28.02.2017 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit”.

Vendimi i KK, është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 80-2017-3056, datë 10.07.2017, ku ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë-padisë dhe lënien në fuqi të vendimit të AK.

Kundër këtij vendimi, nga ana e ndërmarrjes është kryer ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

2. Çështja administrative me kërkuar ndërmarrjen “EMS APO”, person i tretë AK, me objekt: “Pezullimi tërësisht i masave të përkohshme, të vendosura me vendimin e KK nr. 451, datë 28.02.2017 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit”.



Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, me vendimin nr. 31025-01663-80-2017, datë 16.03.2017 vendosi rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

Kundër këtij vendimi, kërkuesi ka ushtruar ankim të veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

3. Çështja administrative me paditës AK, i paditur, ndërmarrja “Tirana-Lines” dhe Palë e tretë Zyra Përmbartimore Tiranë, me objekt: kundërshtim veprimesh përmbartimore. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, vendosi pranimin e padisë së AK, duke detyruar Zyrën e Përmbartimit Tiranë që të vazhdojë me ekzekutimin e pjesës së mbetur të detyrimit.

### **3.2 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Apelit (2017)**

1. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Tirana Lines”, i paditur AK, me objekt: kundërshtimin e vendimit të KK Nr. 290, datë 23.07.2013 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” Sha, “Tirana Lines” Shpk, “Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban Trans” Sha dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” Shpk, për kufizim të konkurrencës në tregun e tregimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit, në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve, në qytetin e Tiranës”. Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, me vendimin nr. 1547, datë 12.04.2017 vendosi rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e KK dhe kthimin e tij në titull ekzekutiv.
2. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Tirana Urban Trans”, i paditur AK, me objekt: shfuqizim i vendimit nr. 290, datë 23.07.2013 të KK. Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje me vendimin nr. 76, datë 19.01.2018 vendosi ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesë padisë, duke lënë në fuqi vendimin e KK nr. 290, datë 23.07.2013.

### **3.3 Çështje të mbartura për gjykim nga Gjykata Administrative e Apelit për vitin 2018**

1. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “AMC” Sha, i paditur AK, me objekt: Pavlefshmëria e vendimit të KK nr. 59, datë 09.11.2007 “Për abuzim me pozitën dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme të shoqërive Albanian Mobile Communication Sha dhe Vodafone Albania Sha”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me këtë çështje, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke konfirmuar ligjshmërinë e vendimit të KK nr. 59, datë 09.11.2007. Kundër këtij vendimi pala paditëse "AMC" Sha, paraqiti ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila pas shqyrtimit vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Kundër këtij vendimi “AMC” paraqiti rekurs pranë Gjykatës së Lartë, e cila pasi e shqyrtoi, vendosi kthimin për rigjykim të kësaj çështjeje pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë dhe jemi në zhvillim të seancave të gjyqësorit ku ka

vijuar procedura e caktimit të ekspertit ekonometrik. Seanca e caktimit të ekspertit ekonometrik për çështjen, ishte në 23 janar dhe seanca gjyqësore e rradhës u la në 27 shkurt 2018.

2. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Hyundai” Shpk, i paditur AK, me objekt: “Shfuqizimi i aktit administrativ, vendimi të KK nr.154, datë 01.10.2010 "Për ndalimin e marrëveshjes midis ndërmarrjeve "Classic" Shpk, "Hyundai Auto Albania" Shpk, "Noti" Shpk dhe "Ultra Motors" Shpk dhe vendosje gjobe ndaj tyre për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja”, lidhur me gjobën për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje me vendimin nr. 4543, datë 21.09.2015 ka vendosur: rrëzimin e kërkesë-padisë; duke lënë në fuqi vendimin e AK. Kundër këtij vendimi, nga ana e ndërmarrjes është kryer ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
3. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “ARMO” Sha, i paditur AK, me objekt: Kundërshtimin e vendimit të KK nr. 150, datë 20.07.2010 "Për abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes "ARMO" Sha në tregun e prodhimit të produktit lëndë djegëse diesel D2". Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2441, datë 17.10.2012 vendosi, lënien në fuqi të vendimit nr. 5681, datë 28.06.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. duke vendosur pranimin e padisë dhe shfuqizimin e vendimit nr. 150, datë 20.07.2010 të KK. Kundër këtij vendimi, AK paraqiti rekurs pranë Gjykatës së Lartë, e cila me vendimin nr. 1445, datë 04.07.2017 vendosi kthimin për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë. Jemi në pritje të shpalljes së datës së gjykimit.
4. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “GECI” Shpk, i paditur Zyra Përmbartimore Tiranë dhe AK, me objekt: Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv, vendimit të KK nr. 229, datë 07.07.2012 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë “Geci” Shpk, për njoftimin jashtë afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përthithjes së shoqërive “Albanian Consortium” Sha dhe “Sky 2009” Sha. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 229, datë 07.07.2012 të AK, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim, vendosi pranimin e kërkesë-padisë. Kundër këtij vendimi, nga ana e AK është kryer ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila pranoi kërkesën e AK, për moskompetencën, duke i kaluar për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë dhe jemi në pritje të gjykimit nga kjo Gjykatë.
5. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Landeslease” Shpk, i paditur AK, person i tretë ndërmaqrria “MUKA” Shpk, me objekt: “Shfuqizimi i vendimit të KK nr. 412, datë 21.04.2016 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në Tregun e Qirasë Financiare dhe në Sektorin Financiar”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje me vendimin nr.3898, datë 21.07.2016 ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë-padisë, duke lënë në fuqi vendimin e AK. Kundër

këtij vendimi, nga ana e ndërmarrjes është kryer ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.

### **3.4 Çështje të gjykuara nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (2017)**

1. Çështja administrative me paditës ndërmarrja "Romano-Port" Sha, i paditur AK, me objekt: Anulim i pikave 1, 2 dhe 3 të vendimit të KK nr. 221, datë 11.04.2012 "Për abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes "Romano Port" Sha, në tregun e ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare".
2. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 221, datë 11.04.2012 të KK, deri në përfundim të gjykimit të çështjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10897, datë 14.11.2012 vendosi pushimin e gjykimit. Ndërmarrja "Romano-Port" Sha, ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila shpalli moskompetencën dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit. Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Kundër këtij vendimi paraqiti rekurs në Gjykatën e Lartë, paditësi, "ROMANO PORT" Sha dhe Gjykata e Lartë me vendimin nr. 893, datë 24.03.2016 vendosi mospranimin e rekursit, duke lënë në fuqi përfundimisht vendimin e KK nr. 221, datë 11.04.2012.

### **3.5 Çështje të mbartura për gjykim nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë për vitin 2018**

1. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen "Alba Trans" Shpk, i paditur AK, me objekt: Kundërshtim i vendimit 290, datë 23.07.2013 të KK, për pjesën që i takon paditësit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, vendosi të pranojë padinë e kësaj ndërmarrjeje. Kundër këtij vendimi nga ana e AK është kryer ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë, në lidhje me këtë çështje shpalli moskompetencën lëndore, në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit, e cila me vendimin nr. 2981, datë 11.07.2014 vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs pala e paditur, AK dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
2. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen "NAZERI" SHRSF & "DEA" SHRSF, i paditur AK, me objekt shfuqizimi i vendimit të KK nr. 240, datë 26.07.2012 "Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve "Eurogjici Security" Shpk, "Toni Security" Shpk, "Eurogjici Security 1" Shpk, "Nazëri – 2000" Shpk dhe "Dea Security" Shpk për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike". Në lidhje me këtë çështje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi, nga ana e AK është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo e fundit, në lidhje me këtë çështje shpalli: moskompetencën lëndore në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo e fundit vendosi lënien në fuqi të

Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs i padituri, AK dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.

3. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “AMC” Sha, i paditur: AK; me objekt anulim i vendimit të KK nr. 26 – 27, datë 02.12.2005 dhe 12.12.2005. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Lartë, pas rekursit të paraqitur nga AK, e cila pas shqyrtimit vendosi ta kthejë këtë çështje për rigjykim në Gjykatën e Apelit, Tiranë. Gjykata e Apelit, Tiranë në lidhje me këtë çështje shpalli moskompetencën lëndore, në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, e cila vendosi pranimin pjesërisht të padisë, duke pushuar gjykimin lidhur për vendimin e KK nr. 26, 02.10.2005 dhe duke pranuar padinë në lidhje me vendimin e KK nr. 27, 12.10.2005. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs AK dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
4. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen ”Ultra-Motors”, i paditur AK, me objekt shfuqizimi i vendimit të KK nr. 154, datë 01.10.2010 "Për ndalimin e marrëveshjes midis ndërmarrjeve "Classic" sh.p.k, "Hyundai Auto Albania" sh.pk, "Noti" sh.p.k dhe "Ultra Motors" Shpk dhe vendosje gjobe ndaj tyre për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja", lidhur me gjobën për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta. Çështja ndodhet për shqyrtim në Dhomën e Këshillimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe jemi në pritje të datës së gjykimit.
5. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Ferlut”, i paditur AK, me objekt kundërshtim i vendimit të KK nr. 290, datë 23.07.2013, për pjesën që i takon paditësit. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 4991, datë 10.06.2015 vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë i padituri, AK dhe jemi në pritje të datës së gjykimit.
6. Çështja administrative me paditës ndërmarrjet “Eurogjici Security” Shpk, "Eurogjici, Security 1" Shpk, "Toni Security" Shpk, i paditur AK, me objekt kundërshtim i vendimit të KK nr. 240, datë 26.07.2012. Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë me vendimin nr. 1400, datë 30.05.2016, vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë i padituri, AK dhe jemi në pritje të datës së gjykimit.
7. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Tirana Urban Trans”, i paditur AK, me objekt kundërshtim i vendimit të KK nr. 290, datë 23.07.2013, për pjesën që i takon Paditësit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi rrëzimin e padisë së ndërmarrjes, duke lënë në fuqi vendimin e AK. Kundër këtij vendimi, nga ana e ndërmarrjes është kryer ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, e cila me vendimin nr.554, datë 17.03.2016 vendosi: Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë paditësi, ndërmarrja “Tirana Urban Trans” Sha, dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.

### Çështjet gjyqësore për vitin 2017

Gjykata Adm. Shk. I	Gjykata Adm. Apel	Gjykata e Lartë
Padi	Ankim	Rekurs
EMS APO	TiranaLines	(Romano Port)
EMS APO	AMC (2%)	Alba Trans
Tirana Lines	Eurogjici	Nazeri
	Hyundai	AMC (1%)
	Geci (Apel civil)	(ARMO)
	Landeslease	Ferlut
	TUT	Ultra-Motors
		Eurogjici
		TiranaUrbanTrans (TUT)
3	7	9

### 3.6 Ekzekutimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës

Në vitin 2017, veprimtaria e AK ka pasur në fokus edhe gjetjen e rrugëve për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve të marra në vite nga KK.

Rezultojnë, se janë 13 vendimmarrje të Komisionit të Konkurrencës, të shoqëruara me gjobat respektive të cilat, duhet të ekzekutohen, për faktin se në zbatim të nenit 80 të ligjit nr. 9121/2003, ato konsiderohen *ispo jure* tituj ekzekutivë.

Po ashtu për vendimet e tjeta, të dala para këtij viti, janë lëshuar urdhërat ekzekutivë përkatës.

Këto vendime, në vite rezultojnë të paekzekutura. Kështu me shkresën nr. 401, datë 06.10.2017, AK i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, por edhe pas kësaj korrespondence vendimet nuk janë ekzekutuar. Në këto rrethana, AK ka kërkuar nga DPP, kalimin e këtyre vendimeve për ekzekutim përmbarrimit privatë. DPP ka refuzuar kalimin e ekzekutimit të këtyre vendimeve tek përmbarruesit privat me justifikimin se kjo nuk është e mundur. Jemi në pritje të vënies në ekzekutim të këtyre vendimeve.

### Lista e titujve ekzekutivë të AK, dërguar në Zyrën e Përmbarrimit

#	Vendimi i Komisionit	Lëshimi i Urdhrit të Ekzekutimit nga Gjykata	Ndërmarrja Debitore	Masa e Gjobës
				LEK
1	Nr. 59 Dt. 09.11.2007 “Vendosje gjobe ndaj AMC Sha dhe Vodafone Sha”	Vendimi Nr. 3359 Dt. 09.11.2010 (Vetëm për AMC Sha)	AMC Sha	211,552,000 (e barabartë me 2% të xhiros të vitit 2006)
2	Nr. 66 Dt. 18.12.2007	Vendimi Nr. 3357 Dt. 22.12.2010	Alban - Tirana Co Best Constriction Alb	447,915 235,367

	“Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve që operojnë në tregun e betonit”		Beton Ekspres Ferro Beton & Const. Halili Ital-Beton Const. Kirchberger - Albania Qarri - 02 Shkodra Beton	178,534 436,959 172,519 201,086 508,279 169,652 396,974
3	Nr. 154 Dt. 01.10.2011 (vetëm për pjesën që i përket Classic Shpk dhe NOTI Shpk)	Vendimi Nr. 2384 Dt. 19.04.2013	Classic Shpk Noti Shpk	25,712,000 2,994,000
4	Nr. 154 Dt. 01.10.2011 (vetëm për “Hyundai Auto Albania” Shpk)	Vendimit Nr. 1611 Dt. 10.02.2012	“Hyundai Auto Albania” Shpk	5,383,000
5	Nr. 123 Dt. 08. 09. 2009 “Vendosje gjobe ndaj Albanian Airlines MAK” Shpk	Vendimi Nr. 3355 Dt. 12.11.2010	“Albanian Airlines Mak” Shpk	2,600,000
6	Nr. 154 Dt. 01.10.2011 (vetëm për “Ultra Motors” Shpk)	Vendimit Nr. 1612 Dt. 27.02.2012	“Ultra Motors” Shpk	1,517,000
7	Nr. 229 Dt. 03.07.2012 “Vendosje gjobe ndaj GECI Shpk për njoftimin e përqendrimit në shkelje të afatit ligjor”	Vendimi Nr. 9771 Dt. 29.10.2012	Geci Shpk	100,000
8	Nr. 290, Dt. 23.07.2013 (vetëm për “Tirana Lines” Shpk )	Vendimi Nr. 368 Dt. 26.02.2015	“Tirana Lines” Shpk	777,618
9	Nr. 290, Dt. 23.07.2013 (vetëm për “Tirana Urban Trans” Sha)	Vendimi Nr. 371 Dt. 18.03.2015	“Tirana Urban Trans” Sha	1,302,498
10	Nr. 290, Dt. 23.07.2013 (vetëm për “Parku i transportit Urban të Udhëtarëve” Shpk)	Vendimi Nr. 370 Dt. 26.02.2015	“Parku i transportit Urban të Udhëtarëve” Shpk	530,906
11	Nr. 265, Dt. 05.02.2013 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes VILOIL Sha”	Vendimi Nr. 7677 Dt. 20.12.2013	Viloil Sha	100,000
12	Nr. 318, Dt. 02.06.2014 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes Heaney Assets Corporation”	Vendimi Nr. 934 Dt. 10.09.2014	Heaney Assets Corporation	100,000

## **PJESA E KATËRT**

### **ROLI I AUTORITETIT TË KONKURENCËS NË FORMULIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E POLITIKAVE TË TJERA - ADVOKACIA E KONKURENCËS**

#### **4.1 Vlerësimi i akteve dhe projekt-akteve normative**

Gjatë vitit 2017, AK ka marrë në shqyrtim dhe vlerësim, në përputhje me ligjin nr. 9121/2003, si me kërkesë të institucioneve propozuese apo edhe me nismën e vet, ka vlerësuar *ex-ante* **4(katër) projekt-ligje** si vijon:

- Projekt- ligji “Për sigurinë, ndërveprimin hekurudhor, për organizimin dhe funksionimin e autoritetit të sigurisë hekurudhore” ;
- Projekt - ligji “Për administruesin e infrastrukturës hekurudhore”;
- Projekt - ligji “Për sipërmarrësin e Transportit Hekurudhor”;
- Projekt - ligji “Për Shërbimin Meteorologjik dhe Hidrologjik Shqiptar”.

#### **3 (tre) projekt-akte normative në tregun e mediave audiovizive për AMA:**

- Projekt -kodi i Transmetimit për Median Audiovizive;
- Projekt-rregullorja “Për komunikimet audio ose/dhe audiovizive, me natyrë tregtare. Format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave”;
- Projekt-rregullorja “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”.

#### **31 (tridhjetë e një) projekt-akteve normative në tregun e energjisë për ERE:**

ERE gjatë vitit 2017, ka dërguar për opinion pranë AK, projekt-aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit 102/2015 “Për sektorin e Gazit Natyror” dhe ligjit nr.138/213 “Për burimet e rinovueshme”.

- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 1, datë 19.01.2017, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe marrëveshjes së pjesëmarrjes në bursën e organizuar të energjisë elektrike” dhe projektit të paraqitur, u konkludua se akti i paraqitur për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
- ERE njoftoi, pranë AK, vendimin e bordit të komisionerëve nr. 2, datë 19.01.2017, për fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e projekt “Marrëveshjes për pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike”. Nga shqyrtimi i projekt marrëveshjes, KK konkludoi se projekt-marrëveshja, në parim nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003. Por, duke marrë në konsideratë perspektivën e tregut dhe rolin specifik të



Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorin e Tregut, sugjerojmë që marrëveshja të përcaktojë qartë dhe të ndajë rolin mes OST dhe OT. Në marrëveshjen përfundimtare, të miratuar me vendim të Bordit të ERE nr. 63, datë 11.05.2017, nuk është reflektuar rekomandimi i KK.

- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 3, datë 19.01.2017, për fillimin e procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të projekt “Rregullores për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrim në tregun e energjisë elektrike”, u konkludua se akti i paraqitur për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 5, datë 19.01.2017, për procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të “Projekt udhëzuesit mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror”, KK rekomandoi: Kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, të sigurojnë trajtim të barabartë, jodiskriminues për pjesëmarrësit e tregut dhe të publikohen: - Në nenin IV, paragrafi 3 të shtohet “Të publikohen kushtet kryesore tregtare për përdorimin e depozitave, linepack dhe shërbimeve ndihmëse, për periudhën aktuale dhe në vazhdim”; - tarifat e aksesit, linepack dhe shërbimeve ndihmëse, të jenë të njëjta dhe jodiskriminuese për të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Rekomandimet janë reflektuar në aktin përfundimtar.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 6, datë 19.01.2017, për procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të projekt-rregullores së procedurave për heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, KK pasi shqyrtoi projektin e paraqitur konkludoi se projekt rregullorja, duhet të parashikojë rastin e heqjes së licencës për subjektin/pjesëmarrësin e tregut të licencuar në dy nivele tregu, të integruar vertikalisht për të shmangur fenomenin “unbundling”. Në vendimin e bordit të ERE nr. 58, datë 18.04.2017 mbi miratimin e “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, nuk janë marrë në konsideratë rekomandimet e KK.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 17, datë 19.01.2017, për procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të “Projekt metodologjisë së tarifave të Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik”, dhe projektit të paraqitur, u konkludua se akti i paraqitur për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE për Certifikimin e OST Sha si operator i pavarur i energjisë elektrike, KK pasi shqyrtoi materialet e paraqitura vlerësoi se është e rëndësishme për konkurrencën, që të mos jenë të integruara vertikalisht ndërmarrjet e prodhimit, transmetimit dhe furnizimit në tregun e gazit natyror dhe të energjisë elektrike (unbundling). Duke propozuar që në certifikimin përfundimtar të OST të mos përfshihet Operatori i Tregut, pra certifikimi dhe funksionimi i tyre të jetë i ndarë sipas parashikimit të neneve 57 dhe 58 të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Po ashtu, edhe në tregun e gazit natyror gjatë procedurës së certifikimit të OST të gazit natyror të kihen parasysh parashikimet e neneve 36 dhe 37 të ligjit nr.

102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, pra aktivitetet e transmetimit, furnizimit dhe shpërndarjes, të çertifikohe si aktivitete të veçanta (unbundling).

- Nga shqyrtimi i vendimit të bordit të ERE nr.43, datë 15.03.2017 “Mbi miratimin përfundimtar të ctë operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST Sha në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 ec, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, vërehet se janë përfshirë edhe rekomandimet e dhëna nga KK.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 18, datë 31.01.2017, për fillimin e procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të “Kontratës/marrëveshjes për shit-blerjen e energjisë elektrike midis KESH Sha dhe OSHEE Sha, për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2017”. KK, i rekomandon ERE që në të ardhmen të marrë në konsideratë ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, me ndryshimet përkatëse në rolet dhe funksionet e aktorëve pjesëmarrës të tregut. Nevojën e plotësimit të kuadrit ligjor, me aktet e nënligjore në zbatim të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 22, datë 15.02.2017 “Për miratimin e Kontratës Tip për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën kohore 01.01.2017 – 31.12.2017”, dhe projektit të paraqitur, u konkludua se akti i paraqitur për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 26, datë 15.02.2017, për fillimin e procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të kontratës së ofrimit të shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë dhe projektit të paraqitur, u konkludua se akti i paraqitur për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr.27, datë 15.02.2017, për fillimin e procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të programit të përputhshmërisë rregullatore” dhe projektit të paraqitur, u konkludua se akti i paraqitur për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr.32, datë 20.02.2017 “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017”, pas shqyrtimit të informacionit të ardhur u konkludua dhe u kërkua nga ERE informacion me më shumë argumente, për kryerjen e analizës së të ardhurave të kërkua dhe kostove reale që përcaktojnë çmimet e shitjes me pakicë për klientët fundorë, që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 prill 2017 deri 31 dhjetor 2017.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr.34, datë 02.03.2017 mbi miratimin e “Udhëzimit mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror”, pas shqyrtimit të informacionit të ardhur u rekomandua “që kriteret për përcaktimin e

aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror të sigurojnë trajtim të barabartë, jodiskriminues për pjesëmarrësit e tregut; si edhe - “tarifat e aksesit, linepack dhe shërbimeve ndihmëse, të jenë të njëjta dhe jodiskriminuese për të gjithë pjesëmarrësit e tregut”.

- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr.58, datë 18.04.2017 për miratimin e “Rregullore për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, pas shqyrtimit të rregullore me anë të shkresës nr. 36/1 prot., datë 23.02.2017, u dërgua komenti dhe opinioni i AK, duke sqaruar se për të shmangur fenomenin “bundling” apo të kompanive të lidhura në treg është sugjeruar që në nenin 5 “Rastet e heqjes së një licence”, të shtohet paragrafi “heqja e licencës për subjektin e licencuar në dy nivele tregu apo të integruara vertikalisht”. Në vendimin përfundimtar të bordit të ERE, nr. 58, datë 18.04.2017 nuk është reflektuar sugjerimi i dhënë.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 59, datë 29.04.2017, për fillimin e procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të “Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë” dhe projektit të paraqitur, u konkludua se akti i paraqitur për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 64, datë 11.05.2017 “Mbi fillimin e procedurave për disa ndryshime në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST Sha dhe Furnizuesit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 23, datë 15.02.2017” dhe projektit të paraqitur, u konkludua se akti i paraqitur për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
- Gjatë vitit 2017 erdhën për opinion disa ndryshime në vendimet e bordit të ERE nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, datë 07.07.2014 për "Rregullat e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit". Nga ana e AK, pas shqyrtimit të informacionit të ardhur iu sugjerua ERE, të marrë në konsideratë “Rregullat e ankandit të zyrës së koordinuar të ankandëve për Evropën Juglindore (see cao)”, konkretisht pikën 5.7, paragrafi 3, ku përcaktohet se në rast se do të paraqiten dy oferta me të njëjtin çmim, do të refuzohet me parë oferta që ka sasinë më të ulët”. Sugjerimet e AK u morën në konsideratë dhe u reflektuan në rregullore.
- ERE me vendimin nr. 90, datë 07.06.2017 “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” Sha për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017” përcaktoi tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror për shoqërinë “ALBGAZ” SH.A me 25 lek/m<sup>3</sup>. Nga shqyrtimi i vendimit u konkludua se argumentet e pjesës konstatuese nuk japin informacion të plotë dhe të qartë që e ka çuar bordin e ERE në këtë vendimmarrje, për miratimin e tarifës.
- Referuar neneve 16/1, 32, 33 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e energjisë”, ERE duhet të miratojë dhe të publikojë metodologjinë e përcaktimit të tarifave sipas veprimtarive në tregun e gazit natyror. Pra, ERE ka miratuar tarifën e mësipërme vetëm mbi bazën e dakortësisë me palët “Albgaz” Sha dhe “Albpetrol” Sha. AK i ka

rekomanduar ERE (shkresa nr.254/1 Prot., datë 19.07.2017) të miratohet dhe publikohet metodologjia e llogaritjes së tarifave, sipas parashikimeve të neneve 16/1, 32, 33 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, e cila të jetë e orientuar drejt kostos mesatare afatgjatë, e miratuar nga ERE dhe e publikuar.

- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 89, datë 07.06.2017 “Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burime të vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, u kthye përgjigje në ERE me shkresën nr 255/1, datë 19.07.2017 për marrje në konsideratë të vendimit e Komisionit të Konkurrencës nr. 408, datë 21.03.2016 për “Disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë mbi draft metodologjinë e tarifës fikse të energjisë elektrike, të prodhuar nga burime të rinovueshme”.
- Në vazhdim të korrespondencës nga ERE u njoftuam për metodologjinë e përcaktimin e tarifave, për të cilën AK u shpreh me shkresën 255/3, datë 27.07.2017, duke qenë se jemi në fazën fillestare të implementimit të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” i konsiderojmë të përshtatshme parashikimet e VKM nr. 369, datë 26.04.2017 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, të cilat i përkasin burimeve të energjisë së rinovueshme të ndërtuara deri në fund të vitit 2017.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 95, datë 04.07.2017 “Mbi miratimin e rregullores dhe procedurave të vendosjes së masave administrative dhe masën konkrete për çdo shkëlqje nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror” dhe projektit të paraqitur, u konkludua se akti i paraqitur për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 98, datë 04.07. 2017 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, të propozuar nga OST”, dhe projektit të paraqitur, u konkludua se akti i paraqitur për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 99, datë 04.07.2017 “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në Marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST Sha dhe furnizuesit të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 23, datë 15.02.2017”, u konkludua se ndryshimet e paraqitura për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim, me ligjin nr. 9121/2003.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 124, datë 16.08.2017 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të përkohshëm për mekanizmin balancues të energjisë elektrike” u konkludua se akti i paraqitur për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 125, datë 16.08.2017 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të harmonizuar të alokimit të kapaciteteve të

interkonjeksionit për vitin 2018, për zyrën e koordinimit të ankandeve të Evropës Juglindore (SEECAO)”, u konkludua se akti i paraqitura për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.

- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr.136, datë 6.09.2017 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, u konkludua se akti i paraqitur për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr.142, datë 06.09.2017 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, iu rekomandua ERE:
  - Draft metodologjia e llogaritjes së tarifave, duhet të jetë e ndarë për secilin operator tregu (transmetimin dhe shpërndarjen) ashtu sikurse janë të parashikuara dhe të ndara rolet dhe funksionet e operatorëve në ligjin nr. 102/2015 “Për gazin natyror”.
  - Draft metodologjia e llogaritjes së tarifave duhet të bazohet në rolet, funksionet dhe kushtet teknike, të parashikuara në modelin e tregut të gazit natyror.
  - Pika 13 e draft metodologjisë, që i referohet tarifave dhe kapacitetit të energjisë duhet të riformulohet, pasi gazi natyror ka si njësi matëse volumin dhe presionin atmosferik, dhe jo lek/KW dhe MWh relevante për energjinë.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr.153, datë 28.09.2017 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e licencës së transmetimit të gazit natyror”, iu rekomandua ERE, që gjatë miratimit të licencës të marrë në konsideratë:
  - Rregullimet ligjore të parashikuara në nenet 36-46 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”;
  - Rregullimet ligjore të parashikuara në nenet 4, 9, 12, 13, 16, 18, 31 të Direktivës 2009/73/CE “Në lidhje me rregullat e përbashkët për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe shfuqizimin e direktivës 2003/55/EC” përsa i përket zotërimit të asetëve, pavarësisë së operatorit, funksionet dhe detyrat e OST, kontrollin dhe zhvillimin e rrjetit, ndërmarrjet e integruara vertikalisht, aksesin në rrjetin e transmetimit dhe mosdiskriminimin.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr.152, datë 28.09.2017 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e licencës për veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, iu rekomandua ERE, që gjatë miratimit të licencës të marrë në konsideratë:
  - Rregullimet ligjore të parashikuara në nenet 68 deri 75 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike;
  - Rregullimet ligjore të parashikuara në pikat 26, 29, 30, 47 si dhe nenet 25 deri 32 të Direktivës 72/2009 EC të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr.157, datë 28.09.2017 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të

Transmetimit të energjisë elektrike”, iu rekomandua ERE, që gjatë miratimit të licencës të marrë në konsideratë:

- Metodologjia duhet të bazohet në parimet dhe rregullat e parashikuara në DIR 72/2009 EC “Në lidhje me rregullat e përbashkët në tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/54/EC”, të cilat parashikojnë që tarifat të reflektojnë kostot, të jenë jodiskriminuese, transparente, të konsultohen me përdoruesit e rrjetit, të jenë me terma afatgjatë, të marrin në konsideratë investimet e domosdoshme dhe të përshtatshme të rrjetit të transmetimit dhe të shmangin kostot e panevojshme të rrjetit;
- Metodologjia për tarifat e operatorit të transmetimit të energjisë elektrike duhet të bazohet në rregullimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” duke mos përfshirë kostot që i përkasin Operatorit të Tregut;
- Të rishikohet dhe riformulohet neni 7, parashikimet e të cilit janë në kontradiktë me nenin 5, kështu në nenin 7 janë përfshirë kostot e amortizimit të kapitalit/aseteve fikse, ndërsa në nenin 5 janë parashikuar si të përjashtuara.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr.156, datë 28.09.2017 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike”, AK i rekomandon ERE që:
- Metodologjia të mbështetet në parimet dhe rregullat e parashikuara në DIR 72/2009 EC “Në lidhje me rregullat e përbashkët në tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/54/EC” të cilat parashikojnë që tarifat të reflektojnë kostot, të jenë jodiskriminuese, transparente, të konsultohen me përdoruesit e rrjetit, të marrin në konsideratë investimet e domosdoshme, të përshtatshme për rrjetin të transmetimit dhe të shmangin kostot e panevojshme të rrjetit.
- Nga shqyrtimi i vendimit të ERE nr. 159, datë 04.10.2017 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullave për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, u konkludua se rregullorja e paraqitur për opinion pranë AK, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003.
- Me shkresën nr. 167/29 prot, datë 23.10.2017, ERE ka dërguar për mendim kontratën e shërbimit të transmetimit të gazit natyror, ndërmjet shoqërisë “Albgaz” Sha dhe “Albpetrol” Sha. KK pasi shqyrtoi kontratën e nënshkruar ndërmjet shoqërisë “Albgaz” Sha dhe “Albpetrol” Sha, vlerësoi se: Kontrata e nënshkruar nga palët, nuk përmban ndonjë klauzolë, e cila bie në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9121/28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, por bazuar në nenin 69 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ERE ka detyrimin ligjor që materialet apo aktet që kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës, të dërgohen përpara nënshkrimit nga palët. Marrëveshja ka ardhur për opinion, pasi ka filluar dhe miratuar zbatimin e saj. Pra, marrëveshja ka filluar zbatimin që nga janari 2017, ndërsa ka ardhur për opinion pranë AK në tetor 2017.



## **4.2 Advokacia e konkurrencës**

### **4.2.1. Konferenca Ndërkombëtare e Konkurrencës**

AK, në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), zhvilloi në datat 11-12 dhjetor 2017 në hotel “Tirana International”, në kuadër të ditës ndërkombëtare të konkurrencës, Konferencën Ndërkombëtare me temë: “13 vjet eksperiencë në politikën e konkurrencës në Shqipëri: aspekte të ligjit, ekonomisë dhe biznesit”, ku merrnin pjesë të ftuar nga autoritetet homologe në Evropë dhe SHBA, përfaqësues nga organizmat ndërkombëtare: BE, OECD, Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), Energy Community Secretariat (ECS) etj., përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe enteve rregullatore në Shqipëri.

Në këtë aktivitet u diskutua veprimtaria e AK, si një institucion publik i pavarur, i cili ka hyrë në vitin e 13 të veprimtarisë së tij në fokus të të cilës ka : Nxitjen dhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, që i shërben mbi gjithçka interesave të konsumatorit, eficiencës së tregjeve si dhe prosperitetit ekonomik dhe social afatgjatë të vendit. Vendimmarrja e AK është përpjekur të vlerësojë të gjithë sektorët e ekonomisë shqiptare, duke u ndalur veçanërisht në sektorët më të ndjeshëm të ekonomisë, të tilla si: karburantet, gazi, telefonia celulare, tregu i sigurimeve, tregu bujqësor, sistemi bankar dhe produktet e tij, si dhe prokurimet publike.

Nga lektorët e huaj, të ftuar në këtë aktivitet u vu theksi se ajo që duhet të përmbushet në funksion të konkurrencës është ekzistenca e tregjeve bazuar në zbatimin e rregullave të ligjit, i cili do të sigurojë: krijimin dhe ruajtjen e tregjeve të lira, gjykata të pavarura dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore, që do të tërheqin investimet private, të huaja dhe vendore dhe që do të krijojnë vende të reja pune.

Nga ana tjetër, liberalizimi ekonomik dhe reformat i shërbejnë: mbrojtjes së konsumatorit të dobët nga kartelet, mbrojtjes së fermerëve të vegjël dhe bizneseve nga abuzimet e blerësve dhe furnizuesve dominues dhe mbrojtjes së konsumatorit nga tarifatat e larta.

Përballë sfidave, që nxjerr procesi i ardhshëm i antarësimit në BE, roli i Autoritetit të Konkurrencës, në një ekonomi gjithnjë e më shumë globale, rrit nevojën për rregulla dhe parime antitrust, në kuadër të një bashkëpunimi më të gjerë ndërkombëtar.

### **4.2.2. Tryezat e Rrumbullakta**

Në lidhje me promovimin e kulturës dhe advokatinë e konkurrencës, AK, zhvilloi disa tryeza të rrumbullakta me komunitetin e biznesit.

Autoriteti i Konkurrencës, gjatë periudhës tetor–dhjetor 2017, organizoi 3 tryeza të rrumbullakëta, në qytetet e Elbasanit, Fierit dhe Durrësit, me temë “Kontributi i Autoritetit të Konkurrencës në zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve”, ku u paraqitën



dy dokumente: (1) Programi i lehtësimit nga gjobat; (2) Programi i përputhshmërisë me rregullat e konkurrencës. Prezantimi i këtyre dokumenteve synoi ndërgjegjësimin e komunitetit të biznesit në respektimin e rregullave të konkurrencës, si dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit të tyre me Autoritetin e Konkurrencës.

## PJESA E PESTË

### INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

#### 5.1 Kontributi në kuadrin e Integritit Evropian

Procesi intregimit, përbën një nga prioritetet dhe sfidat e veprimtarisë së AK. Si një institucion lider për kapitullin e 8 “Politika e konkurrencës dhe liberalizimi”, AK, gjatë vitit 2017 ka përmbushur misionin e tij, fokusuar në këto drejtime kryesore:

Në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) në terma afatmesëm, për vitet 2016-2020 për kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”, AK, në respektim të afateve kohore, ka realizuar përafrimin e legjislacionit të konkurrencës me *acquis* të BE, përkatësisht dy akte sekondare:

- Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve të transferimit të teknologjisë”, miratuar me vendimin nr. 489, datë 20.12.2017 të KK;
- Broshurë Informuese “Programi i përputhshmërisë me rregullat e konkurrencës”.

Si lider dhe koordinator i kapitullit 8 “Politika e Konkurrencës”, që përbëhet nga tre komponentë: Konkurrenca, Ndihma Shtetërore dhe Liberalizimi. AK raporton në mënyrë periodike pranë MEPJ, si dhe pranë Komitetit i Stabilizim-Asociimit dhe Nënkomitetit për “Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën, të përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”.

Takimi i 9 i nënkomitetit BE-Shqipëri për “Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën u prezantua në muajin tetor 2017. Në këtë takim, u raportua puna mbi aktivitetin AK, për tregjet e monitoruara, procedurat hetimore dhe vlerësimet e kryera nga AK, rritjen e kulturës dhe advokacisë së konkurrencës dhe ndërmarrja e nismave të reja ligjore, në drejtim të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Gjatë vitit 2017, si drejtues të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian, nën drejtim e AK u mbajtën 10 takime institucionale, për çëshjet të liberalizimit të tregut. Për vitin 2018, AK do të vazhdojë të jetë pjesë integrale e strukturës institucionale për procesin e anëtarësimit në BE.

#### 5.2 Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Gjatë veprimtarisë së vitit 2017, AK ka synuar forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me institucionet homologe, forumet dhe qendrat e trajnimeve të konkurrencës në rajon e më gjerë.

### **5.2.1. Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës (ICN)**

AK, është anëtare me të drejta të plota në Rrjetin Ndërkombëtar të Konkurrencës, që është rrjeti më i madh që përfshin pothuajse të gjitha autoritetet e konkurrencës në Evropë dhe botë, që nga viti 2004.

AK gjatë vitit 2017, ka ndërmarrë një rol më aktiv pranë ICN, duke u bërë pjesë e grupeve të ndryshme të punës, përkatësisht:

- Grupi punës për avokacinë (Advocacy Working Group).
- Grupi punës për efektivitetin e autoritetit (Agency Effectiveness Working Group).
- Grupi punës për kartelet (Cartel Working Group).
- Grupi punës për përqendrimit (Mergers Working Group).
- Grupi punës për sjelljen e njëanshme në rastet e abuzimit të pozitës dominuese (Unilateral Conduct Working Group).

Si pjesë e këtyre grupeve të punës, AK ka paraqitur eksperiencën shqiptare në lidhje me përgatitjen e materialeve dhe pjesëmarrjen në aktivitetet e organizuara gjatë vitit 2017, përkatësisht:

- Pyetëtori për grupin e punës së karteleve për “Programi i lehtësimit nga Gjobat”.
- Pyetëtori për grupin e punës për efektivitetin e autoritetit për “Rolin e ekonomistëve në autoritetet e konkurrencës”.
- Pjesëmarrje në teleseminarin me temë: “Roli i analizave ekonomike në autoritetet e konkurrencës”, shtator 2017.
- Pjesëmarrjen në konferencën: “Konferenca vjetore për vitin 2017 e ICN” e organizuar në Porto të Portugalisë, maj 2017.
- Pjesëmarrja në seminarin e ICN me temë: “Lufta kundër karteleve dhe marrëveshjeve në oferta në tregun e prokurimeve publike” e organizuar në Otava, Kanada, shtator 2017.

### **5.2.2. Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD)**

AK është përfaqësuar në dy aktivitete të OECD, duke paraqitur pervojën shqiptare, si më poshtë:

- Seminari me temë “Përzgjedhja e sektorëve ose industrive prioritare për studimet e tregut”, organizuar në mars 2017, ku u diskutua mbi qëllimin e përdorimit të studimeve të tregut, si një formë e promovimit të advokacisë së konkurrencës midis shteteve pjesëmarrëse dhe mbi aspektet strategjike në përzgjedhjen e sektorëve për studim.

- Forumi Global i Konkurrencës, i organizuar në dhjetor 2017, në të cilin u diskutuan në një aspekt më të gjerë, problemet që sjell konkurrenca në tregje duke e lidhur edhe me fusha të tjera të zhvillimit ekonomik.

### **5.2.3. Qendra Rajonale e Konkurrencës (OECD-GVH RCC)**

Gjatë vitit 2017, Autoriteti i Konkurrencës vijoi bashkëpunimin me OECD-GVH/ RCC nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme që kjo qendër ofron për vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

AK, mori pjesë në aktivitetet e mëposhtme:

- Seminari për “Tregun Përkatës” organizuar në mars 2017.
- Konferenca vjetore e Kryetarëve të Autoriteteteve të Konkurrencës, në maj 2017.
- Seminari “Mbi vlerësimin e ligjeve dhe rregullave të konkurrencës”, në shtator 2017.
- Seminari “Praktikat më të mira në procedurat kartel”, në tetor 2017.
- Seminari “Rregullat e Konkurrencës dhe Sektori Farmaceutik”, në dhjetor 2017.

Për herë të parë, AK u bë pjesë edhe e rrjetit të shkëmbimit të informacionit (Reques Information Form – RFI) midis autoriteteve homologe, për çështje apo problematika që ato hasin në punën e përditëshme të tyre dhe për të cilat kërkohet dhënia e përgjigjeve adekuate.

Si rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm vitin e kaluar, për vitin 2018, OECD-GVH/ RCC, ka përzgjedhur Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës, si vendin pritës për të organizuar së bashku në Tiranë, nga datat 19-21 qershor, seminarin me temë “Për kontrollin e përqendrimeve”, ku do të marrin pjesë përfaqësues nga vendet e rajonit dhe ekspertë ndërkombëtarë.

### **5.2.4. Sofia Competition Forum (SCF)**

Autoriteti i Konkurrencës, si pjesë aktive e këtij forumi, për vitin 2017, ka marrë pjesë në forumin e 10 të SCF me temë “Kartelet dhe shkëmbimi i informacionit midis konkurrentëve”.

Gjithashtu, AK ka publikuar tre artikuj për rastet e konkurrencës në Shqipëri, në funksion të zbatimit të ligjit për konkurrencën në buletin e përvitshëm të SCF, përkatësisht:

- Programi i përputhshmërisë, bazuar në rregullat e konkurrencës;
- Tregu i sigurimeve në Shqipëri;
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në lidhje patentat standarde të telekomunikacionit në Evropë.

### **5.2.5. Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD)**

AK i kushton një rëndësi të madhe politikave të konkurrencës dhe ka bashkëpunuar me UNCTAD. Në 2017, në Gjenevë u organizua nga UNCTAD takimi i “Grupit Ndërqeveritar të Ekspertëve mbi Konkurrencën, Ligjin dhe Politikat”. Në këtë takim, Kryetari i AK mori pjesë si panelist, i ftuar në seksionin me temë: “Sfidat e regjimeve të kontrolleve të përqendrimeve për autoritetet e vogla dhe të reja të konkurrencës”.

### **5.2.6. Observatori i Transportit për Evropën Jug-Lindore (SEETO)**

AK angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në aktivitetet e organizuara nga SEETO, duke qenë pjesë e paneleve të takimeve të grupeve të punës duke trajtuar konkretisht aspekte të konkurrencës në sektorin e transportit në Shqipëri.

Për 2017, AK mori pjesë në 2 aktivitete të organizuara nga kjo organizatë:

- Takimi i 27 i Grupit të Punës për Hekurudhat në qershor 2017;
- Takimi i 28 i Grupit të Punës për Hekurudhat në tetor 2017.

### **5.2.7. Komuniteti i Sekretariatit të Energjisë (ECS)**

AK, gjatë vitit 2017, ka vijuar kooperimin me Sekretariatit e Energjisë nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave për tregun e energjisë në Shqipëri, si dhe pjesëmarrjes në eventet e mëposhtme:

- Seminar me temë “Mbështetja dhe arbitrazhi në sektorin e energjisë” në nëntor 2017;
- Konferencë me temë “Ligji i Konkurrencës në Sektorin e Energjisë” në dhjetor 2017;
- Seminar me temë “Funksionimi i programeve të lehtësimit nga gjocat” në dhjetor 2017.

AK, ka raportuar rregullisht, pranë ECS, në lidhje me rekomandimet e dhëna nga KK për tregun e Energjisë Elektrike dhe Tregun e Gazit Natyror në Shqipëri.

Gjatë vitit 2017, mbështetur në rekomandimet e Sekretariatit dhe duke i marrë në konsideratë ato, KK nuk u shpreh me një vendimmarrje, për të përjashtuar “Marrëveshjen ndërmjet KESH-OSHEE për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në kushtet e prurjeve të mëdha hidrike”.

Qëndrimi i KK, u bazua në kuadrin e ri ligjor të miratuar, përkatësisht ligjin nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i cili ka sjellë ndryshim të rolit dhe funksionit të aktorëve pjesëmarrës në këtë treg dhe në kuadrin e ri rregullator, përkatësisht “Rregullores për procedurën e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes, për plotësimin e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin nr.103, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE.

## PJESA E GJASHTË

### RISTRUKTURIMI I ORGANIZIMIT TË AUTORITETIT

#### 6.1 Ristrukturimi i AK


AK në funksion të përmbushjes së misionit të tij dhe për t'iu përshtatur zhvillimit ekonomik të vendit, si në fushën e prodhimit, ashtu edhe atë të shërbimit, si dhe për të shkuar në koherencë edhe me modelet e vendeve anëtare të BE dhe ato të rajonit, për të realizuar një ekspertizë cilësisht më të mirë në funksion të monitorimit dhe hetimit të tregjeve në raport edhe me detyrimet që burojnë nga procesi i integritimit në BE, i propozoi Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, strukturën e re, e cila me vendimin nr.43/2017 u miratua nga ana e tij.

Nëpërmjet kësaj strukture, AK:

- Realizon analiza, studime, hetime dhe autorizime të përqendrimeve që njoftohen pranë Autoritetit. Në strukturën e re, u miratua një pozicion i ri kyç – Kryekonomisti, i cili kryen analiza të veçanta ekonomike dhe ekonometrike, për të lejuar një zgjidhje më të plotë dhe adekuate për çështje të konkurrencës në treg.
- Autoriteti i Konkurrencës, duke qenë lider në Kapitullin 8, në procesin e integritimit në BE dhe duke qenë pjesë e drejtpërdrejtë e negociatave për anëtarësim, krijoi një drejtori të re, atë të Integritimit Evropian dhe Komunikimit.

Struktura e miratuar tashmë, ka në përbërjen e saj 5 drejtori teknike dhe një drejtori mbështetëse dhe është në përputhje me: ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblymjet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” që drejtohen nga sekretari i përgjithshëm, i cili përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Sekretariatit, zbatimin e procedurave të ligjit nr. 9121/2003 për shqyrtimin e rasteve, hartimin dhe paraqitjen e raportit përmbledhës të hetimit pranë Komisionit për vendimarrje, si dhe menaxhimin financiar të Institucionit.

Ky ristrukturim, e ka sjellë këtë Institucion më afër me natyrën dhe dinamikën që paraqet tregu sot në Shqipëri, duke imponuar edhe një rregullim të dukshëm në përputhje me kërkesat dhe nevojat e konsumatorit, në funksion të rritjes së mirëqenies së tij.




## 6.2 Realizimi i buxhetit për vitin 2017

Gjatë vitit 2017 përdorimi i Buxhetit, ka qenë konform kërkesave të ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe është përdorur me efikasitet për plotësimin e kushteve dhe kërkesave të punonjësve, për realizimin e detyrave të ngarkuara.

Buxheti është realizuar në masën 98.4 %, i ndarë në zërat sipas aneksit bashkëlidhur këtij raporti.

Në grafikun e mëposhtëm, pasqyrohet në % çdo kategori shpenzimesh, përkundrejt totalit të realizuar të buxhetit:



## 6.3 Të ardhurat e realizuara

Gjatë këtij viti, në buxhetin e shtetit është derdhur si e ardhur nga përqëndrimet (njoftim dhe autorizim përqëndrimi) shuma 8.020.000 lekë.

**Tabela e shpenzimeve të AK për vitin 2017**

Kodi	Emërtimi	Plani ( me ndryshime)	Fakti	/
		Lekë		
600	Paga , shpërblime etj	45,641,000	45,383,786	99%
601	Kontribute për Sigurime Shoqërore	7,000,000	6,894,741	98%
602	Materiale dhe Shërbime	12,060,000	11,318,836	94%
231	Investime	1,000,000	988,200	99%
<b>Totali</b>		<b>66,752,000</b>	<b>65,616,565</b>	<b>98.40%</b>

## Të ardhurat të realizuara nga përqëndrimet të derdhura në buxhet për vitin 2017

Kodi	Emërtimi	Fakti
		Lekë
711	Të ardhura të derdhura në buxhet	8,020,000






## 6.4 Rekrutimet

Gjatë vitit 2017, në kuadër dhe të ristrukturimit janë realizuar 7 procedura rekrutimi me ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil. Të gjitha procedurat janë realizuar konform kërkesave të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.



Gjatë vitit 2017, janë realizuar 24 trajnime jashtë vendit dhe 4 brenda vendit, ku është trajnuar një numër i konsiderueshëm prej 44 punonjësish të institucionit, ku një pjesë e punonjësve rezultojnë të jenë trajnuar më shumë se një herë. Të gjitha trajnimet janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të AK me ICN, RCC OECD dhe brenda vendit, nga Shkolla e Administratës Publike, kryesisht lidhur me HRMIS-in dhe për hedhjen e pagesave në sistemin e përgjithshëm financiar.



## **PJESA E SHTATË**

### **PRIORITETET E AK PËR VITIN 2018**

#### **7.1 Prioritetet e AK për vitin 2018**

- AK, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 9121/2003, për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, do të ketë si prioritetet të veprimtarisë së tij mbikëqyrjen dhe hetimin në tregjet me sensitive të ekonomisë shqiptare dhe me impakt të drejtpërdrejtë në interesat dhe mirëqenien e konsumatorit, përkatësisht: tregu i telekomunikacioneve, tregu i energjisë, tregu i hidrokarbureve, tregu financiar dhe i sigurimeve, si dhe tregu i agrobiznesit.
- AK, në zbatim të nenit 69 të ligjit nr.9121/2003, do të forcojë bashkëpunimin me institucionet e administratës qendrore dhe vendore, lidhur me vlerësimin për çdo projekt-akt normativ, që në mënyrë të veçantë ka të bëjë me:
  - vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta;
  - kufizimet sasiore për hyrje në treg dhe tregtimin;
  - imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.
- AK, në zbatim të nenit 70 të ligjit nr.9121/2003, do të bashkëpunojë me entet rregullatore, në kuadër të rolit të Autoritetit për rregullimin dhe reformën rregullatore, në sektorët e rregulluar.

#### **7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE-së**

Gjatë vitit 2018 AK do të:

- AK do të forcojë kapacitetet administrative nëpërmjet një shtese në strukturën organizative të AK, si dhe nëpërmjet trajnimeve sipas sektorëve, mbështetur edhe me projektet ku AK është përfitues, me qëllim rritjen e cilësisë së inspektimit, hartimit të raporteve, cilësisë së mbrojtës së vendimeve të komisionit në proceset gjyqësore etj..
- AK do të vazhdojë të monitorojë rregullisht zbatimin e MSA, si pjesë përbërëse e saj në Kapitullin e 8 si dhe të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, duke dhënë kontributin përkatës për takimin e Nënkomitetit të Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencës.
- AK, si përfitues i një projekti IPA II, me vlerë 700 000 euro, synon të forcojë kapacitetet institucionale.
- AK do të jetë përfitues i një projekti me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) “Asistencë Teknike për AK- Rritje e Kapaciteteve, Hartim i Legjislacionit dhe Advokacia”.

- Në kuadër të instrumentit të asistencës afatshkurtër TAIEX, pritet të realizohet gjatë vitit 2018 forcimi i kapaciteteve të stafit, lidhur me analizat ligjore dhe analizat ekonomike në shqyrtimin e rasteve të konkurrencës.
- Në kuadër të bashkëpunimit me UNCTAD, AK ka si objektiv të tij: realizimin e një projekti të përbashkët me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Competition and Consumer Protection Policy in Albania”, ku parashikohet trajnimi i stafit të AK në lidhje me vlerësimin e të drejtave ekskluzive dhe të veçanta, vlerësimin e procedurave të prokurimit publik për marrëveshjet e ndaluara në oferta, vlerësimin gjatë procedurave të kontrollit të përqendrimeve, shkëmbime eksperiencash.
- AK, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, do të jetë institucioni pritës dhe organizues i një aktiviteti ndërkombëtar me pjesëmarrjen e anëtarëve të rrjetit rajonal OECD- GVH/RCC.

## ANEKS

### VENDIMET E KOMISIONIT TË KONKURENCËS

- 1 KK me vendimin nr. 446, datë 16.01.2017 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në të gjitha segmentet e tregut të importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsum familjar dhe biznes”.
- 2 KK me vendimin nr. 447, datë 16.01.2017 vendosi “Për dhënien e disa rekomandimeve bashkisë Berat për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit funeral”.
- 3 KK me vendimin nr. 448, datë 23.01.2017 vendosi “Për revokimin e pjesëshëm të vendimit nr. 443, datë 30.11.2016 të Komisionit të Konkurrencës “Për masat dhe detyrime për ndërmarrjet e sigurimit dhe disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare mbi rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta””.
- 4 KK me vendimin nr. 449, datë 21.02.2017 vendosi “Për miratimin e Raportit Vjetor "Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2016 dhe sfidat kryesore për vitin 2017””.
- 5 KK me vendimin nr. 450, datë 28.02.2017, vendosi “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit”.
- 6 KK me vendimin nr. 451, datë 28.02.2017 vendosi “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit”.
- 7 KK me vendimin nr. 452, datë 07.03.2017 vendosi për “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të JT International Tirana Shpk nga Marketing & Distribution Shpk nëpërmjet JT International Holding B.V.”.
- 8 KK me vendimin nr. 453, datë 07.03.2017 vendosi për “dhënien e disa rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe bankat e nivelit të dytë”.
- 9 KK me vendimin nr. 454, datë 21.03.2017 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës për konsum familjar dhe biznes”.
- 10 KK me vendimin nr. 455, datë 28.03.2017 vendosi për “Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës”.
- 11 KK me vendimin nr. 456, datë 28.03.2017 vendosi për “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Tobacco Press d.o.o. Mostar dhe Aseteve të Duhanit të Fabrika Duhana Sarajevo d.d. nga British American Tobacco Investments Limited”.
- 12 KK me vendimin nr. 457, datë 11.04.2017 vendosi për “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Reynolds American INC nga Batus Holding INC”.
- 13 KK me vendimin nr. 458, datë 14.04.2017 vendosi “Për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Komisionit të Konkurrencës”.

- 14 KK me vendimin nr. 459, datë 25.04.2017 vendosi për "Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Fannie May Confections Brands Inc. nga Ferrero International S.A".
- 15 KK me vendimin nr. 460, datë 02.05.2017 vendosi "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 450, datë 28.02.2017 "Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit".
- 16 KK me vendimin nr.461, datë 23.05.2017 vendosi "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare".
- 17 KK me vendimin nr. 462, datë 23.05.2017 vendosi "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregtimit të produkteve lëndë e parë, për prodhimin e brumrave për bukë dhe nënproduktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes "Nelly" Shpk"
- 18 KK me vendimin nr. 463, datë 06.06.2017 vendosi për "Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrjeje të re, të pavarur me funksione të plota ndërmjet "BMW AG / Daimler AG / Ford Motor Company / Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft".
- 19 KK me vendimin nr. 464, datë 06.06.2017 vendosi për "Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të rrjetit të shpërndarjes së shoqërisë Fabrika Duhana AD Banja Luka, si edhe përfitimin 100% të aksioneve të Express Logistic& Distribution EOOD nga British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited".
- 20 KK me vendimin nr. 465, datë 20.06.2017 vendosi për "Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 49% të ndërmarrjes ITD Shpk, nga INVESTMENT JOTI-INFOSOFT GROUP Shpk tek Balfin Shpk".
- 21 KK me vendimin nr. 466, datë 20.06.2016 vendosi "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e distribucionit dhe shfaqjes së filmave në rrjetet e kinemave në Tiranë".
- 22 KK me vendimin nr. 467, datë 04.07.2017 vendosi "Për marrjen e disa masave për rregullimin e konkurrencës në tregun e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak".
- 23 KK me vendimin nr. 468, datë 04.07.2017 vendosi për "Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 100% të ndërmarrjes Compal Electronics Europe sp z.o.o nga Compalead Electronics B.V tek Vestel Ticaret A.S.".
- 24 KK me vendimin nr. 469, datë 11.07.2017 vendosi "Për dhënien e rekomandimeve në lidhje me certifikimin paraprak të shoqërisë "Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror, Albgaz Sha".
- 25 KK me vendimin nr. 470, datë 11.07.2017 vendosi "Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant, në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar "Tirana International Airport".
- 26 KK me vendimin nr. 471, datë 25.07.2017 vendosi për "Vlerësimin si jashtë kompetence të ankesës së "Ora" Sha dhe përcjelljen e ankesës pranë Autoritetit të Mediave Audiovizuale".
- 27 KK me vendimin nr. 472, datë 14.09.2017 vendosi "Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e tregtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumërave për bukë dhe nënproduktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes "Nelly" Shpk".

- 28 KK me vendimin nr. 473, datë 14.09.2017 vendosi për “Autorizimin i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së asetëve të ndërmarrjes Izi Mobil Telekomunikacije d.d. nga Telekom Slovenije d.d”.
- 29 KK me vendimin nr. 474, datë 14.09.2017 vendosi për “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së disa asetëve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të ndërmarrjes Veneto Banca S.p.A nga Intesa Sanpaolo S.p.A ”.
- 30 KK me vendimin nr. 475, datë 21.09.2017 vendosi “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve”.
- 31 KK me vendimin nr. 476, datë 05.10.2017 vendosi “Për zbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 390, datë 22.12.2015 dhe mbylljen e hetimit të thelluar në të gjitha segmentet e tregut të ngarkim- shkarkimit, importit, depozitimit dhe shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm, për konsum familjar dhe biznes”.
- 32 KK me vendimin nr. 477, datë 12.10.2017 vendosi “Për hapjen e procedurës se hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS Albanian Port Operator” Shpk, në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit dhe aktiviteteve të lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit”.
- 33 KK me vendimin nr. 478, datë 26.10.2017 vendosi për “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit mbi shitjen dhe transferimin e kuotës prej 90% të ndërmarrjes Insig Jete Sha, nga Eurosig Sha tek Z. Shefqet Kastrati dhe Z. Samir Mane”.
- 34 KK me vendimin nr. 479, datë 26.10.2017 vendosi “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e shfaqjes së filmave në kinema në qytetin e Tiranës”.
- 35 KK me vendimin nr. 480, datë 09.11.2017 vendosi “Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve ndërmarrjes Jordan d.o.o tek Telekom Slovenije d.d”.
- 36 KK me vendimin nr. 481, datë 16.11.2017 vendosi “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë, në lidhje me kushtet e licencës së aktivitetit të shpërndarjes së gazit natyror”.
- 37 KK me vendimin nr. 482, datë 16.11.2017 vendosi “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me kushtet e licencës së aktivitetit të furnizimit të gazit natyror”.
- 38 KK me vendimin nr. 483, datë 16.11.2017 vendosi “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me kushtet e licencës së aktivitetit të tregtimit të gazit natyror”.
- 39 KK me vendimin nr. 484, datë 23.11.2017 vendosi për “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes Plus Communication Sha tek Vodafone Albania Sha”.
- 40 KK me vendimin nr. 485, datë 23.11.2017 vendosi për “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes Plus Communication Sha tek Telekom Albania Sha”.
- 41 KK me vendimin nr. 486, datë 05.12.2017 vendosi për “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të ndërmarrjes Fitzroy Merger CO, tërësisht e kontrolluar nga CTH Invest S.A me Ferrara Candy Company Holdings Inc”.

- 42 KK me vendimin nr. 487, datë 05.12.2017 vendosi për “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit mbi Portofolin e Kredisë së Procredit Bank AD Beograd nga Banca Intesa AD Beograd”.
- 43 KK me vendimin nr. 488, datë 05.12.2017 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit”.
- 44 KK me vendimin nr. 489, datë 20.12.2017 vendosi “Për miratimin e rregullores “Për Kategoritë e Marrëveshjeve të Transferimit të Teknologjisë””.
- 45 KK me vendimin nr. 490, datë 20.12.2017 vendosi “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines”.
- 46 KK me vendimin nr. 491, datë 28.12.2017 vendosi “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të mirëmbajtjes të pajisjeve fiskale për tregtimin e karbuanteve”.
- 47 KK me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 vendosi “Për dhënien e disa rekoandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT, në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotur”.





**AUTORITETI I  
KONKURRENCËS**

Rruga SAMI FRASHËRI, nr. 4, kati IV,  
Tiranë 1004

+355 42234504  
competition@caa.gov.al  
caa.gov.al